



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 58

25 maj

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i GJK nr. 28, datë 9.5.2012	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të neneve 69, 70 dhe 87 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. - Pezullimi i ekzekutimit të zbatimit të neneve 68, 70 dhe 87 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”	2883
Vendim i GJK nr. 29, datë 15.5.2012	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës të Shqipërisë, të vendimit nr.577, datë 4.11.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe vendimit unifikues nr.5, datë 15.9.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë....	2897
Vendim i GJK nr. 30, datë 16.5.2012	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.....	2901
Vendim i GJK nr. 31, datë 17.5.2012	Me objekt vlerësimin e pajtueshmërisë së nenit 147, pika 4 dhe 6 të Kodit të Procedurës Penale me nenet 3, 4, 42/2 dhe 135 të Kushtetutës.....	2906

VENDIM
Nr. 28, datë 9.5.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Anëtar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Pilloçi	Anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar	i	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	/Anëtare	e	“	“

me sekretare Enina Mullaj, në datën 14.07.2011 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 31/9 Akti, që i përket:

KËRKUES: Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptarë, përfaqësuar nga kryetari i saj Selami Jenishehri.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj dhe Arjeta Çefa, me autorizim.

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i neneve 69, 70 dhe 87 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”;
- Pezullimi i ekzekutimit të zbatimit të neneve 68, 70 dhe 87 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

BAZA LIGJORE: Nenet 1/3, 3, 131/a dhe 134/1/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 49, 50 dhe 51 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatoren e çështjes Altina Xhoxhaj, përfaqësuesin e kërkuarit që kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara që kërkuan rrëzimin e kërkesës dhe, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (Kuvendi), me ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, ka miratuar Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Në nenin 69 të këtij Kodi parashikohet se: “1. Një grup zgjedhësish në një zonë zgjedhore kanë të drejtë të propozojnë një kandidat për atë zonë zgjedhore, i cili përmbush kushtet e përcaktuara në nenet 45 dhe 69 të Kushtetutës dhe ato të përcaktuara në këtë Kod, jo më vonë se 40 ditë nga data e zgjedhjeve. 2. Kandidati i propozuar nga një grup zgjedhësish nuk mund të jetë pjesë e asnjë partie apo koalicioni që konkurron në zgjedhje dhe as të mbështesë haptazi apo në mënyrë të tërthortë ndonjë subjekt apo kandidat tjetër që konkurron në zgjedhje. 3. Për paraqitjen e një kandidati nga zgjedhësit, krijohet një komitet nismëtar me jo më pak se 9 zgjedhës nga zona zgjedhore përkatëse, të cilët janë të ngarkuar të organizojnë punën për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin, sipas këtij Kodi. Jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve komiteti nismëtar regjistrohet në KQZ, duke paraqitur emrat e anëtarëve të komitetit. Komiteti mund të regjistrojë një kandidat për deputet vetëm në rast se ka



marrë mbështetje për kandidatin nga një numër zgjedhësish që i korrespondon jo më pak se 1 për qind të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore, sipas procedurave të përcaktuara në Kod.”

2. Në nenin 70 të Kodit Zgjedhor parashikohet se: “1. Një grup zgjedhësish me banim në zonën zgjedhore kanë të drejtë të propozojnë një kandidat për kryetar të bashkisë apo komunës dhe/ose një kandidat për këshillin vendor, jo më vonë se 40 ditë nga data e zgjedhjeve. 2. Kandidati i propozuar nga një grup zgjedhësish nuk mund të jetë pjesë e asnjë partie apo koalicioni që konkurron në atë zonë zgjedhore dhe as të mbështesë haptazi apo në mënyrë të tërthortë ndonjë subjekt apo kandidat tjetër që konkurron në atë zonë zgjedhore. 3. Për paraqitjen e kandidatit nga zgjedhësit, krijohet një komitet nismëtar me jo më pak se 9 zgjedhës nga zona zgjedhore përkatëse, të cilët janë të ngarkuar për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin. Jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve, komiteti nismëtar regjistrohet në KZAZ, duke paraqitur emrat e anëtarëve të komitetit. Komiteti mund të regjistrojë një kandidat për kryetar të bashkisë apo komunës vetëm nëse ka marrë mbështetje për kandidatin nga një numër zgjedhësish që i korrespondon jo më pak se 1 për qind të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore, sipas procedurave të përcaktuara në këtë Kod. 4. Kandidatët e partive politike për kryetar të njësisë të qeverisjes vendore apo listat shumemërore të partive për këshillat vendorë, përjashtohen nga detyrimi i parashikuar në pikën 3 të këtij neni, nëse të paktën një anëtar i partisë përkatëse zotëron një mandat në Kuvend ose në këshillin, për të cilin partia politike kandidon në zgjedhje. Për qëllim të këtij Kodi, partia politike paraqet një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit. 5. Kandidatët e propozuar nga zgjedhësit përjashtohen nga detyrimi i parashikuar në pikën 3 të këtij neni, nëse janë kryetarë bashkie a komune. 6. Partitë politike përjashtohen nga detyrimi i parashikuar në pikën 3 të këtij neni, nëse partia përkatëse zotëron një mandat në Kuvend ose në këshillin, për të cilin partia politike kandidon në zgjedhje. Për qëllim të këtij Kodi, partia politike paraqet një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit.”

3. Në nenin 87 të Kodit Zgjedhor parashikohet se: “1. Subjektet zgjedhore përfitojnë financime nga fondet publike, sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kod. Sasia e fondeve publike që do t'u shpërndahen subjekteve zgjedhore caktohet me vendim të Kuvendit së bashku me buxhetin e zgjedhjeve, sipas nenit 86 të këtij Kodi. 2. Sasia e fondeve publike që i shpërndahet secilit prej subjekteve zgjedhore caktohet me vendim të KQZ-së, sipas rregullave të mëposhtme: a) 50 për qind e shumës ndahet ndërmjet partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore dhe që kanë mandate në Kuvend, e përcaktuar kjo sipas vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve pararendëse. Kjo shumë u jepet këtyre partive politike nga KQZ-ja jo më vonë se 5 ditë pas regjistrimit të tyre si subjekt zgjedhor dhe paraqitjes së listës shumemërore për çdo zonë zgjedhore. Shuma shpërndahet mbi bazën e numrit të mandateve të fituara në zgjedhjet për Kuvendin; b) 50 për qind e shumës së përgjithshme ndahet midis partive politike të regjistruara si subjekt zgjedhor dhe që në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin kanë marrë jo më pak se 2 vende në Kuvend, në raport me votat e marra prej tyre në shkallë kombëtare, sipas vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve pararendëse. 3. Partia që ka përfituar fonde publike, sipas shkronjës "b" të pikës 1 të këtij neni dhe që nuk fiton asnjë mandat nga zgjedhjet e radhës, duhet të kthejë shumën përkatëse të përfituar. Depozitimi i këtyre shumave bëhet në llogarinë bankare të KQZ-së. Kthimi i fondeve bëhet jo më vonë se 30 ditë pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Në rast të mospërbushjes së këtij detyrimi, pa shkaqe të përligjura, KQZ-ja i kërkon Ministrin të Financave që të urdhërojë Zyrën e Thesarit që këto shuma t'i mbajë nga fondet e tjera buxhetore që përfitojnë këto parti dhe t'i kalojë ato në buxhetin e KQZ-së. 4. Partia, e cila nuk kthen fondet përkatëse sipas pikës 3 të këtij neni, humbet të drejtën e financimeve të tjera nga fondet publike për një periudhë kohe jo më pak se 5 vjet, si dhe nuk regjistrohet si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e radhës, pavarësisht llojit të tyre, as vetëm dhe as si pjesëtare e ndonjë

koalicioni. 5. Fondet e kthjera, sipas pikës 3 të këtij neni, me vendim të KQZ-së, u rishpërndahen partive politike, të cilat kanë marrë vende në Kuvend. Shpërndarja bëhet në përqindje të njëjtë me përqindjen e vendeve të fituara në zgjedhjet e radhës. Vendimi merret nga KQZ-ja jo më vonë se 30 ditë pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. 6. Në rast se fondi, sipas pikës 4 të këtij neni, nuk është kthyer plotësisht nga subjektet zgjedhore, ky fond i kompensohet KQZ-së nga Buxheti i Shtetit. 7. KQZ-ja nxjerr udhëzimet përkatëse në zbatim të këtij neni.”

4. Dispozitat e sipërcituara janë kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata) nga kërkuesi, Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptarë (PBPPSH), i cili parashtron, në thelb, këto shkaqe për të mbështetur kërkesën e tij:

i) Nenet 69 dhe 70 të Kodit Zgjedhor mbajnë një qëndrim favorizues ndaj partive që përfaqësohen me deputetë në Kuvend dhe qëndrim diskriminues ndaj partive të reja që nuk përfaqësohen, gjë që bie në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës. Kjo sepse një parti që hyn për herë të parë në zgjedhje, të përgjithshme ose vendore, ose që nuk zotëron mandat në Kuvend, i nënshtrohet një procedure jo vetëm të gjatë por dhe që kërkon fonde, duke krijuar disavantazh për këto subjekte zgjedhore.

ii) Bazuar në nenet 69 dhe 70 të Kodit Zgjedhor, partitë e reja nuk mund të garojnë të vetme, por detyrimisht duhet të bëjnë pjesë në një koalicion zgjedhor. Këto kushtëzime apo kufizime që i bëhen pjesëmarrjes së një subjekti të ri politik në garën elektorale janë barriera për çdo subjekt të ri politik dhe cenojnë të drejtën kushtetuese të barazisë në zgjedhje, të parashikuar në nenin 1/3 të Kushtetutës. Kufizimet e pjesëmarrjes së barabartë të partive në zgjedhje kanë ndikimin e tyre negativ edhe për funksionimin e pluralizmit, të sanksionuar në nenin 3 të Kushtetutës.

iii) Neni 87 i Kodit Zgjedhor parashikon përfitimin e financimeve nga fondet publike vetëm për partitë politike parlamentare, duke krijuar një situatë diskriminuese për subjektet e tjera zgjedhore që nuk janë parti parlamentare. Për shpërndarjen e fondeve, për përgatitjen e zhvillimit të zgjedhjeve, nuk parashikohen fare partitë e vogla, në një kohë që në nenin 86/2 të Kodit Zgjedhor përcaktohet qartë qëllimi i këtij fondi për përgatitjen, zhvillimin, mbikëqyrjen dhe çdo aspekt të procesit zgjedhor. Edhe ky kufizim që i bëhet një subjekti të ri politik në garën elektorale bie në kundërshtim me të drejtën kushtetuese të barazisë në zgjedhje, të parashikuar në nenin 1/3 të Kushtetutës.

5. Subjekti i interesuar, Kuvendi, parashtron në mënyrë të përmbledhur se:

5.1 Për legjitimitimin e kërkuesit

- Në kuptim të nenit 134/2 të Kushtetutës kërkuesi ka detyrimin kushtetues të provojë lidhjen e domosdoshme ndërmjet funksionit dhe veprimtarisë që kryen dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Në rastin objekt shqyrtimi kërkuesi kërkon shfuqizimin e dy neneve (69 dhe 70) që nuk kanë lidhje me regjistrimin e partive politike, por që përcaktojnë procedurat e regjistrimit të kandidatëve të pavarur dhe, në këto kushte, ky objekt i kërkesës nuk ka lidhje me interesat e kërkuesit.

5.2 Për themelin e kërkesës

- Në rastin në shqyrtim ndodhemi para “gjësë së gjykuar”. Me vendimin nr.32, datë 21.6.2010 Gjykata ka trajtuar kushtetutshmërinë e neneve 68 dhe 71 të Kodit Zgjedhor dhe ka shprehur qëndrimin e saj lidhur me to, duke konstatuar se është cenuar parimi i barazisë në zgjedhje, si rrjedhojë e përcaktimit të numrit të zgjedhësve që duhej të mbështesnin kandidatin e pavarur ose listën e kandidatëve të partive politike që nuk zotëronin asnjë mandat në Kuvend. Në kërkesën objekt shqyrtimi kundërshtohet pikërisht përcaktimi i vendosur nga ligjvënësi në lidhje me numrin e zgjedhësve të zonës zgjedhore për efekt të regjistrimit të subjekteve zgjedhore, në nenet 69 dhe 70 të Kodit Zgjedhor. Nga krahasimi i dy kërkesave konstatohet se pretendimet dhe baza ligjore e tyre janë identike. Qëllimi është i njëjtë dhe bëhet fjalë për nene të të njëjtit kapitull, atij “Regjistrimi i subjekteve zgjedhore”. Edhe në lidhje me nenin 87 të kundërshtuar, Gjykata është shprehur po në atë vendim, kur ka arsyetuar në lidhje me shpërndarjen e fondeve publike.

- Pretendimi për cenimin e parimit të barazisë në zgjedhje nuk qëndron. Përcaktimi i numrit



të zgjedhësve (jo më pak se 1%) në nenet 69 dhe 70 të Kodit Zgjedhor lidhet më shumë me aftësitë, meritat, ndikimin apo popullaritetin që ka çdo kandidat për deputet apo kryetar bashkie/komune me zgjedhësit. Qëllimi i ligjvënësit, përmes këtyre dy neneve dhe këtij ligji në tërësi, ka qenë pikërisht respektimi i parimit të barazisë së zgjedhjeve dhe kjo vërtetohet nga fakti se përmes këtyre dy neneve ligjvënësi i ka dhënë mundësi, në mënyrë të barabartë, kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit që të kandidojnë për deputetë, apo kryetar bashkie/komune.

- Përcaktimi i mbështetjes nga një numër zgjedhësish, që përbëjnë jo më pak se 1% të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore është përcaktuar në frymën e Udhëzimeve dhe Raportit Shpjegues të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, i miratuar nga Komisioni i Venecias.

- Sistemi proporcional i zgjedhjeve i jep çdo partie të vogël një mundësi për t'u përfaqësuar në Parlament, por ky sistem vendos edhe përcaktimin e votave të nevojshme për t'u përfaqësuar. Përcaktimet e neneve 69, pika 3 dhe 70, pika 3 të Kodit Zgjedhor janë rrjedhojë e këtij sistemi.

- Në lidhje me nenin 87 të Kodit Zgjedhor nuk jemi në kushtet e nenit 18/2 të Kushtetutës, pasi ai nuk ka të bëjë me gjendjen ekonomike të kërkuesit dhe nuk sjell kosto financiare për të. Përmes këtij neni ligjvënësi ka pasur në konsideratë ndarjen e fondit për zgjedhjet sipas partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore, ndërkohë që neni 18 i Kushtetutës parashikon se subjekti nuk mund të diskriminohet për shkak të gjendjes së tij ekonomike.

6. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, parashtrori në mënyrë të përmbledhur se:**

6.1 *Për legjitimitimin e kërkuesit*

- Kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae* për t'iu drejtuar Gjykatës. Nenet 69/3 dhe 70/3 të Kodit Zgjedhor nuk përcaktojnë rregulla mbi mënyrën e kandidimit të kandidatëve të propozuar nga partitë politike, sikundër është kërkuesi, por të kandidatëve të propozuar nga një numër i caktuar zgjedhësish. Regjistrimi i partive politike dhe kandidatëve të tyre bëhet sipas neneve 64 dhe 67 të Kodit Zgjedhor. Në kushtet kur këto dispozita zbatohen ndaj kandidatëve të pavarur dhe nuk i shtrijnë efektet mbi kërkuesin, ai nuk ka asnjë interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në çështjen e ngritur.

6.2 *Për themelin e kërkesës*

- Në përputhje me hapësirën kushtetuese të veprimit dhe në përmbushje të funksionit të tij ligjvënës, Kuvendi ka përcaktuar në Kodin Zgjedhor se një kandidat që synon të marrë pjesë në zgjedhje dhe që nuk mbështetet nga asnjë parti politike duhet të mbështetet nga një numër zgjedhësish që i korrespondon 1% të numrit të votuesve në atë zonë zgjedhore. Ky rregullim është proporcional dhe justifikohet nga interesi publik, për pengimin e fragmentarizmit të tepruar të partive politike dhe kandidatëve në zgjedhje, por edhe me synimin për të garantuar kandidatura serioze ose në përjashtimin e atyre që nuk kanë mundësi suksesi.

- Përmes këtij rregullimi ligjvënësi nuk krijon pabarazi ndërmjet partive politike apo kandidatëve për një konkurrim të lirë ndërmjet tyre. Kjo për faktin se parimi i mosdiskriminimit nuk mund të nënkuptojë barazi absolute trajtimi, sepse ligji trajton në mënyrë të ndryshme në situata të ndryshme.

- Në lidhje me nenin 87 të Kodit Zgjedhor, ky parashikim lidhet me faktin se partitë politike kanë nevojë për financim të përshtatshëm për të përmbushur funksionet e tyre si gjatë, ashtu edhe ndërmjet periudhave zgjedhore. Sistemet e financimit publik synojnë t'u sigurojnë të gjitha partive mundësinë për të konkurruar në zgjedhje në përputhje me parimin e mundësive të barabarta. Për këtë qëllim, shpenzimet e fushatës elektorale duhet të kufizohen tek një tavan, në përputhje me situatën e vendit dhe të fiksuar me numrin e votuesve respektivë. Shteti duhet të marrë pjesë në shpenzimet e fushatës nëpërmjet financimit të barabartë të një përqindjeje të caktuar në tavanin e mësipërm, ose proporcional me numrin e votave të marra, megjithatë ky kontribut mund të refuzohet për partitë të cilat nuk marrin një prag të caktuar votash.

II

A. Për kërkesën për pezullimin e zbatimit të neneve 69, 70 dhe 87 të Kodit Zgjedhor

7. Gjykata mori paraprakisht në shqyrtim kërkesën për pezullimin e zbatimit të neneve 69, 70 dhe 87 të Kodit Zgjedhor deri në dhënien e një vendimi përfundimtar prej saj. Në kuptim të nenit 45 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullim, për arsye se nuk gjeti argumente bindëse për cenimin e interesave shtetërore, shoqërore ose të individëve, si rrjedhojë e zbatimit të dispozitave objekt kërkesë.

B. Për legjitimitimin e kërkuarit për të iniciuar kontrollin kushtetues të neneve 69, 70 dhe 87 të Kodit Zgjedhor

8. Gjykata vlerëson se kërkuari legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës. Kërkuari është një person juridik i regjistruar sipas ligjit nr.8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike”, me vendimin nr.3378, datë 24.04.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

9. Kërkuari legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit 3-vjeçar të parashikuar nga neni 50 i ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

10. Për sa i përket legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata rithekson se në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet që parashikohen në nenin 134, pika 2 të Kushtetutës kanë detyrimin të provojnë lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet funksionit dhe veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Partitë politike janë të specifikuar në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës si një ndër ato subjekte që e ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar kësaj Gjykate, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Gjykata ka theksuar se, në kuptimin kushtetues dhe ligjor, partitë politike paraqiten si bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, bindjeve dhe pikëpamjeve politike të përbashkëta, që synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhje dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit. Bazuar në nenin 2 të ligjit nr.8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike”, ato marrin pjesë në formimin e vullnetit politik të popullit në të gjitha fushat e jetës publike dhe kryesisht nëpërmjet: a) ndikimit në krijimin e opinionit publik dhe të edukatës politike; b) nxitjes së pjesëmarrjes aktive të shtetasve në jetën politike dhe evidentimin e aftësimit të shtetasve për të marrë përsipër përgjegjësi publike; c) pjesëmarrjes në zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore. Partitë politike në sistemin e zgjedhjeve dhe veçanërisht në procesin zgjedhor, që nga fushata parazgjedhore, paraqitja e kandidatëve, formimi i trupave zgjedhore, ndjekja e zgjedhjeve e deri te ndarja e mandateve, paraqiten si një faktor përcaktues shumë i rëndësishëm. Prandaj, demokracia përfaqësuese, ashtu edhe sistemi i zgjedhjeve nuk mund të paramendohen pa ekzistencën dhe funksionimin e partive politike. Ky pozicion i veçantë që partitë politike kanë në raport me zgjedhjet, përcakton njëkohësisht dhe interesin e tyre për të pasur një legjislacion dhe rregulla sa më të qarta e të drejta (shih vendimet nr.1, datë 07.01.2005 dhe nr.32, datë 21.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

11. Në lidhje me legjitimitimin e partive politike, Gjykata ka vlerësuar se ato mund ta venë këtë Gjykatë në lëvizje atëherë kur kundërshtojnë dispozitat e akteve normative, të cilat cenojnë statusin e tyre kushtetues dhe bashkë me të edhe pjesëmarrjen në ushtrimin e vullnetit shtetëror. Për këtë arsye, Gjykatës i takon të shqyrtojë nëse një organ kushtetues ka cenuar të drejtat e partive politike nëpërmjet aktit normativ të nxjerrë prej tij. Në këtë rast, partia politike legjitimohet në kërkimet e saj nëse bëhet fjalë për respektimin nga ana e një organi kushtetues të statusit të saj që rrjedh nga Kushtetuta, gjatë procesit zgjedhor, si p.sh. financimi i partive politike nga shteti, dhënia e shansit të barabartë të gjitha partive për të marrë pushtetin, etj. Për partinë politike, si subjekt i



cilësuar nga dispozita e nenit 134/1/f, lidhen me interesat e tyre të gjitha ato akte përmbajtja e të cilave sjell pasoja negative për veprimtarinë e tyre kushtetuese në kuadër të formimit të vullnetit politik (shih vendimin nr.15, datë 15.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

12. Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar se dispozitat objekt kërkesë cenojnë të drejtën kushtetuese të barazisë në zgjedhje. Duke iu referuar dispozitave të Kodit Zgjedhor të kundërshtuara, objekt i kërkesës, Gjykata vëren se kërkuesi ka arritur të provojë interesin e tij vetëm në lidhje me nenet 70 dhe 87 të Kodit Zgjedhor, dispozita këto që rregullojnë dhe pra ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në veprimtarinë e partive politike, duke ndikuar në këtë mënyrë në pjesëmarrjen e tyre në formimin e vullnetit politik. Në lidhje me nenin 69 të Kodit Zgjedhor, Gjykata vëren se ai rregullon procedurën për regjistrimin në zgjedhjet e përgjithshme të kandidatit të propozuar nga një grup zgjedhësish, duke parashikuar se ky subjekt zgjedhor nuk mund të jetë pjesë e asnjë partie apo koalicioni që konkurron në zgjedhje. Në kushtet kur kjo dispozitë, në ndryshim nga neni 70 i Kodit Zgjedhor, shprehet vetëm për kandidatët e pavarur dhe nuk bën asnjë rregullim për kandidatët e partive politike, qofshin ato parti parlamentare ose jo, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet për kundërshtimin e saj, pasi ajo nuk rregullon, dhe në këtë mënyrë as nuk prek, në mënyrë të drejtpërdrejtë veprimtarinë e partisë politike si subjekt zgjedhor. Pra, në lidhje me nenin 69 të Kodit Zgjedhor kërkuesi nuk ka arritur të justifikojë interesin e tij në kuptim të nenit 134/2 të Kushtetutës.

C. Për pretendimin për ndërhyrjen e parimit të gjësë së gjykuar

13. Përpara vlerësimit në themel të pretendimeve të kërkuesit, Gjykata çmon të ndalet në pretendimin e subjektit të interesuar, Kuvendi, se në rastin në shqyrtim gjendemi para gjësë së gjykuar. Kuvendi pretendon se me vendimin nr.32, datë 21.06.2010 Gjykata ka trajtuar kushtetutshmërinë e disa prej dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe se, në thelb, kërkimet e kërkuesit në kërkesën objekt shqyrtimi dhe baza ligjore e referuar janë të njëjta me ato për të cilat Gjykata e ka shprehur tashmë qëndrimin e saj.

14. Gjykata ka theksuar se në gjykimin kushtetues “res judicata” njihet si një nga tre format e efekteve që merr vendimi gjyqësor në procedurën abstrakte të kontrollit të kushtetutshmërisë së normave juridike. Në aspektin formal e procedural ajo nënkupton përfundimin, në drejtim të mosankueshmërisë së vendimit, ndërsa, në atë substancial, nënkupton fuqinë e detyrueshme të vendimit. Ky parim është i zbatueshëm jo vetëm ndaj palëve në gjykim, por edhe ndaj të gjitha autoriteteve publike brenda juridiksionit që janë të interesuara ose të përfshira në përmbajtjen e vendimit të gjykatës. Tipar karakteristik i gjësë së gjykuar është se kur në vendimin e parë çështja e ngritur është konsideruar e pabazuar në themel, ajo nuk mund të shqyrtohet më tej. Në rastet kur nuk është shprehur pajtueshmëria kushtetuese e normës juridike, kërkuesi nuk ndalohet të bëjë përsëri të njëjtën kërkesë me motiv rishikimin e normës për pajtueshmëri me Kushtetutën (*shih vendimin nr.29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata vëren se me vendimin nr.32, datë 21.06.2010, i është dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit lidhur me pajtueshmërinë me Kushtetutën të neneve 68 dhe 71 të Kodit Zgjedhor, ndërkohë që me kërkesën objekt shqyrtimi asaj i është kërkuar të shprehet lidhur me dispozita të ndryshme nga ato të marra në shqyrtim në vendimin e mësipërm, konkretisht nenet 69, 70 dhe 87 të Kodit Zgjedhor. Edhe pse këto dispozita përfshihen në të njëjtin kapitull të Kodit Zgjedhor, në kushtet kur vendimi i mëparshëm nuk rezulton të ketë pasur një efekt çfarëdo mbi dispozitat e kundërshtuara, ai nuk përbën asnjë pengesë të aspektit kushtetues. Për sa kohë që kërkuesit kanë paraqitur një kërkesë me objekt të ndryshëm, edhe pse për të njëjtat shkaqe dhe me të njëjtën bazë ligjore, Gjykata nuk ka asnjë pengesë ligjore për të marrë në shqyrtim këtë kërkesë.

Ç. Për pretendimin për shfuqizimin e nenit 70 të Kodit Zgjedhor

16. Kërkuesi pretendon se neni 70 i Kodit Zgjedhor cenon të drejtën e tij kushtetuese për zgjedhje të barabarta, të sanksionuar nga neni 1/3 i Kushtetutës dhe parimin e pluralizmit, të sanksionuar nga neni 3 i Kushtetutës.

17. Gjykata rithekson se kushti bazë për pluralizmin janë zgjedhjet e lira, shumësia e interesave, lejimi i hapësirave për organizimin e mekanizmave të presionit ndaj organeve të pushtetit dhe një shtet që është i përgjegjshëm ndaj nevojave të qytetarëve. Në çdo sistem demokratik, përfaqësuesit e popullit në qeverisje zgjidhen përmes zgjedhjeve shumëpartiake, të lira, të barabarta dhe të ndershme. Pushteti i përfaqësuesve kufizohet nga Kushtetuta dhe mekanizma të tjerë të balancimit dhe kontrollit të pushteteve. Problemet e përfaqësimit të drejtë janë çështje të shanseve të barabarta, që zëri i gjithkujt të dëgjohet apo të jetë i përfaqësuar. Sidoqoftë, është e lejueshme që një shtet demokratik, nëse ekzistojnë arsye serioze, të vendosë në mekanizmat e procesit zgjedhor disa elemente nxitëse të integritetit shoqëror. Nga ana tjetër, një sistem zgjedhor proporcional i pakufizuar mund të rezultojë në ndarjen e votave të qytetarëve ndërmjet një numri shumë të madh partish politike dhe, për pasojë, në një kërcënim për funksionimin dhe vazhdimësinë e sistemit parlamentar, në kuptim të kapaciteteve për të arritur në një vendimmarrje brenda tij (*shih vendimin nr.32, datë 21.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Neni 3 i Kushtetutës parashikon pluralizmin si një nga bazat e shtetit, ndërsa neni 1, paragrafi 3 i saj sanksionon parimin e barazisë së votës, i cili ka komponentin e tij aktiv (e drejta për të votuar) dhe atë pasiv (e drejta për t'u votuar/zgjedhur). Gjykata rithekson se parimi i barazisë së të drejtës për t'u votuar/zgjedhur ndalon shtetin të diskriminojë ose të privilegjojë kandidatë të caktuar, parti politike ose grupe të tjera politike në përballjen konkurruese për të tërhequr votën e zgjedhësit. Barazia në zgjedhje përfshin shumë aspekte dhe parimet që duhen respektuar në të gjitha rastet janë barazia në votën numerike, barazia për sa i përket fuqisë zgjedhore dhe mundësive të barabarta, ku kjo e fundit kërkon që midis partive dhe kandidatëve duhet të krijohen shanse të barabarta dhe shteti duhet të jetë i paanshëm ndaj tyre, duke zbatuar ligjet në mënyrë të njëjtë për të gjithë (*shih vendimin nr.32, datë 21.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata ka theksuar se është e rëndësishme për çdo shtet të së drejtës që zbaton rregullat e një shoqërie demokratike, të gëzojë hapësira të konsiderueshme për të përcaktuar rregulla dhe kritere të drejta brenda rendit të tij kushtetues, në përputhje me kushtet konkrete si dhe me faktorët e ndryshëm politikë, historikë, socialë, kulturorë, tradicionalë, të cilët janë përcaktues. Në koncept, parimi i konkurrimit të lirë të partive politike përfshin detyrimin e shtetit për të respektuar shanset e barabarta të të gjitha partive dhe zbatohet në legjislacionin që rregullon kushtet e këtij konkurrimi, si dhe në konfliktet ndërmjet pjesëmarrësve në të. Ligjvënësi ka hapësirë veprimi për të vlerësuar vetë, duke parashikuar në ligj kritere të tilla që i përgjigjen në realitet dhe objektivisht parimit të barazisë së votave dhe përfaqësimit të barabartë, por çfarëdolloj ndërhyrjeje nga ligjvënësi duhet të udhëhiqet nga interesi publik. Ligjvënësi e ka të ndaluar të trajtojë palët në mënyrë diskriminuese, përveçse kur ekzistojnë arsye të forta përjashtimore për ta bërë këtë. Gjykata rithekson gjithashtu se detyra e saj nuk është që të vihet në rolin e ligjvënësit pozitiv dhe të përcaktojë rregullimet ligjore, por të kontrollojë nëse zgjidhja që jep ligjvënësi nëpërmjet përcaktimeve të kritereve ligjore është ose jo në përputhje me dispozitat e Kushtetutës (*shih vendimet nr.1, datë 07.01.2005 dhe nr.32, datë 21.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata vëren se, edhe pse kërkuesi në objekt të kërkesës kundërshton të gjithë përmbajtjen e nenit 70 të Kodit Zgjedhor, pretendimet e tij, në thelb, i referohen pikave 4 dhe 6 të nenit 70 të Kodit Zgjedhor, në të cilat parashikohet se: “4. Kandidatët e partive politike për kryetar të njësisë të qeverisjes vendore apo listat shumëmbrore të partive për këshillat vendorë, përjashtohen nga detyrimi i parashikuar në pikën 3 të këtij neni, nëse të paktën një anëtar i partisë përkatëse zotëron një mandat në Kuvend ose në këshillin, për të cilin partia politike kandidon në zgjedhje. Për qëllim të këtij Kodi, partia politike paraqet një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i



Kuvendit apo njësia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit. 6. Partitë politike përjashtohen nga detyrimi i parashikuar në pikën 3 të këtij neni, nëse partia përkatëse zotëron një mandat në Kuvend ose në këshillin, për të cilin partia politike kandidon në zgjedhje. Për qëllim të këtij Kodi, partia politike paraqet një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit.”

21. Duke iu referuar, në tërësi, dispozitave të Kodit Zgjedhor, rezulton se procedura e regjistrimit të subjektit zgjedhor parti politike ose koalicioni partish politike, rregullohet nga nenet 63 – 67 të këtij Kodi, kurse nenet 69 dhe 70 të tij rregullojnë procedurën për regjistrimin e kandidatëve të propozuar nga një grup zgjedhësish, respektivisht për zgjedhjet në Kuvend dhe ato për organet e qeverisjes vendore. Këto dy dispozita parashikojnë se ky subjekt zgjedhor (kandidati i propozuar nga zgjedhësit) nuk mund të jetë pjesë e asnjë partie apo koalicioni që konkurron në zgjedhje dhe as të mbështesë haptazi apo në mënyrë të tërthortë ndonjë subjekt apo kandidat tjetër që konkurron në zgjedhje dhe se ky kandidat mund të regjistrohet vetëm nëse ka marrë mbështetje nga një numër zgjedhësish që i korrespondon jo më pak se 1 për qind të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore. Ndërkohë që në nenin 70, në pikat 4 dhe 6 të tij, në ndryshim nga neni 69, janë parashikuar edhe disa përjashtime nga ky detyrim për kandidatët që vijnë nga partitë politike që kanë të paktën një mandat në Kuvend ose në këshillin për të cilin partia kandidon. Gjykata vëren se, edhe pse në thelb neni 70 i Kodit Zgjedhor i drejtohet dhe rregullon regjistrimin e kandidatëve të pavarur, pra që nuk vijnë nga partitë politike por që kërkojnë të marrin pjesë në zgjedhje me anë të mbështetjes së zgjedhësve, nga një interpretim *a contrario* i pikave 4 dhe 6 të kësaj dispozite rezulton se, duke parashikuar përjashtimin nga ky detyrim vetëm të kandidatëve që vijnë nga partitë politike me të paktën një mandat në Kuvend ose në këshillat përkatës, kërkesa për të siguruar mbështetjen e një numri zgjedhësish që i korrespondon jo me pak se 1% të listës së zgjedhësve zbatohet, përveç se për kandidatët e pavarur, edhe për ata kandidatë që vijnë nga partitë politike të cilat nuk kanë mandate në Kuvend ose në këshillat përkatës. Ky rezulton të jetë edhe interpretimi që vetë KQZ-ja i ka bërë kësaj dispozite, e cila në rastin e kandidatëve të propozuar nga këto të fundit, kërkon që ata të provojnë mbështetjen nga një numër zgjedhësish që i korrespondon jo më pak se 1 për qind të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore, për efekt të regjistrimit të tij në listën e kandidatëve që konkurrojnë për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore.

22. Bazuar në përmbajtjen e pikave 4 dhe 6 të nenit 70 të Kodit Zgjedhor, Gjykata vlerëson se gjendet përpara një kufizimi të pjesëmarrjes së barabartë të partive në zgjedhje dhe, në këto kushte, detyrë e saj është të vlerësojë nëse ky kufizim është proporcional me qëllimin që kërkohet të arrihet. Ajo rithekson se parashikimi i kriterëve të tilla apo dhe përcaktimi i numrit të nënshkrimeve që duhet të mbledhur mbetet një atribut i ligjvënësist, por ky përcaktim duhet të jetë i drejtë. Detyrimi për të mbledhur një numër të caktuar firmash për të paraqitur kandidaturën është teorikisht në përputhje me parimin e votimit universal, por ky detyrim nuk duhet të pengojë kandidatët të vendosin kandidaturat e tyre. Konkurrimi i lirë ndërmjet partive është një shfaqje e drejtpërdrejtë e natyrës pluraliste të shoqërisë demokratike dhe është pikërisht mbrojtja e pluralizmit në jetën politike që ka kuptim për vetë ekzistencën e kësaj shoqërie. Gjykata thekson se çdo kufizim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë mbi barazinë e partive në konkurrimin zgjedhor nuk duhet të ketë një pasojë diferencuese ose të përbëjë një trajtim preferencial për disa parti, ose të ndalojë pjesëmarrjen e partive politike në konkurrimin zgjedhor. Bazuar në standardet e trajtuara më sipër, ajo vlerëson se nuk rezultojnë arsye të përligjura kushtetuese për të krijuar një dallim të këtij dimension ndërmjet partive politike, kandidatët e të cilave janë zgjedhur në Kuvend (partitë parlamentare) dhe partive të tjera (joparlamentare), çka realisht bëhet përmes nenit 70 të Kodit Zgjedhor. Një rregullim i tillë nuk justifikohet me ndonjë interes publik, me pengimin e fragmentarizmit të tepruar të partive politike dhe as me synimin për të siguruar kandidatura serioze në zgjedhje ose përjashtimin e atyre që nuk kanë mundësi suksesi dhe, për pasojë, është joproporcional.

Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuetit në lidhje me nenin 70, pika 4 dhe 6, të Kodit Zgjedhor janë të bazuara dhe këto dispozita duhet të shfuqizohen si të papajtueshme me Kushtetutën.

D. Për pretendimin për shfuqizimin e nenit 87 të Kodit Zgjedhor

23. Në lidhje me nenin 87 të Kodit Zgjedhor, kërkueti pretendon se edhe përmbajtja e kësaj norme është në kundërshtim me parimin e barazisë së partive politike përballë shtetit dhe parimin e shanseve të barabarta në konkurrimin politik.

24. Gjykata vëren se, duke qenë se qëllimi kryesor i partive politike është marrja e pushtetit me mjete dhe mënyra demokratike, elementi kryesor që karakterizon veprimtarinë politike të partive është konkurrenca midis tyre. Konkurrimi i lirë është shprehje e drejtpërdrejtë e natyrës pluraliste të një shoqërie demokratike dhe bazohet edhe në faktin që për të gjitha partitë politike zbatohen të njëjtat rregulla të përcaktuara më parë. Këto rregulla bazohen në parimin e mosdiskriminimit, të mostrajimit preferencial të disa partive ndaj disa të tjerave, duke u dhënë atyre mundësi të njëjta në konkurrimin politik. Çdo kufizim në barazinë e palëve në konkurrimin elektoral nuk mund të arrijë deri në atë masë që të bëjë të pamundur vetë pjesëmarrjen e partive politike në konkurrim. Gjykata vlerëson se midis partive dhe kandidatëve duhet të krijohen shanse të barabarta dhe shteti duhet të jetë i paanshëm ndaj tyre, duke zbatuar ligjet në mënyrë të njëjtë për të gjithë. Në veçanti, kërkesa për asnjësi zbatohet për fushatën zgjedhore dhe mbulimin nga media, veçanërisht media publike, si dhe për financimin publik të partive dhe fushatave, e cila mund të realizohet si në formën e një barazie “strikte”, ashtu dhe të barazisë “proporcionale”. Sipas barazisë “strikte”, partitë politike trajtohen pa marrë në konsideratë forcën e tyre aktuale në Kuvend ose të zgjedhësve, ndërsa sipas barazisë “proporcionale”, trajtimi i partive bëhet në raport me numrin e votave (*shih vendimin nr.32, datë 21.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjykata rithekson se partitë politike luajnë një rol të rëndësishëm në sistemin demokratik pluralist pasi kontribuojnë në shfaqjen e vullnetit politik të popullit përmes pjesëmarrjes në zgjedhje dhe ndihmojnë në realizimin e sovranitetit të tij. Për shkak të këtyre funksioneve ato kanë status kushtetues dhe konsiderohen elementë të domosdoshëm të jetës politike. Në mënyrë që të kryejnë këto funksione, partitë politike kanë burime financiare që përbëhen si nga të ardhura private ashtu edhe të ardhura nga buxheti i shtetit. Financimi i partive politike nga buxheti i shtetit përbën vetëm një pjesë të të ardhurave të tyre. Bazuar në nenin 17 të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” (të ndryshuar), burimet financiare dhe materiale të partive politike përbëhen nga kuotat e anëtarësisë, nga fondet publike, duke përfshirë edhe ndihmën financiare në masën e caktuar në Buxhetin e Shtetit të miratuar me ligj nga Kuvendi, fondet jopublike, të cilat janë dhurimet financiare, dhurimet në natyrë, shërbimet, sponsorizimet, kreditë apo garancitë e ndryshme, si edhe çdo transaksion tjetër financiar. Financimi i partive politike nga shteti nuk është një parim kushtetues, megjithatë atje ku zbatohet ai duhet të respektojë parimin e konkurrimin të lirë të subjekteve, në kuptim të hyrjes së lirë të tyre në garën zgjedhore. Financimi i shtetit për partitë politike është thelbësor për të garantuar pavarësinë e tyre nga burimet e tjera financiare dhe për t’i siguruar mundësinë për të konkurruar nga një pozicion i barabartë. Sa më shumë partitë politike subvencionohen nga shteti aq më pak ato ndjejnë nevojën të kërkojnë ndihmë për veprimtarinë e tyre nga burime të tjera. Në lidhje me buxhetin e miratuar për mbështetjen financiare të partive politike gjatë periudhës zgjedhore, në nenin 87 të Kodit Zgjedhor është parashikuar se këto fonde shpërndahen në këtë mënyrë:

- 50 për qind e shumës ndahet ndërmjet partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore dhe që kanë mandate në Kuvend, e përcaktuar kjo sipas vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve pararendëse. Shuma shpërndahet mbi bazën e numrit të mandateve të fituara në zgjedhjet për Kuvendin;

- 50 për qind e shumës së përgjithshme ndahet midis partive politike të regjistruara si subjekt



zgjedhor dhe që në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin kanë marrë jo më pak se 2 vende në Kuvend, në raport me votat e marra prej tyre në shkallë kombëtare, sipas vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve pararendëse.

26. Sipas Kodit të Praktikës së Mirë në Fushën e Partive Politike (*miratuar nga Komisioni i Venecias në Mbledhjen e tij të 77-të Plenare, Venecia 12-13 dhjetor 2008, shih më gjerë dokumentin CDL-AD(2009)002*), atje ku legjislacioni parashikon financimin publik, partitë politike duhet të kenë akses dhe të jenë subjekte të kërkesave/kritereve minimale, të cilat duhet të jetë të arsyeshme dhe jo diskriminuese. Bazuar në Direktivat për Financimin e Partive Politike (e *miratuar nga Komisioni i Venecias në mbledhjen e tij të 46-të plenare, Venecia 9-10 mars 2001, shih më gjerë dokumentin CDL-INF (2001)008*), financimi publik duhet t'i drejtohet secilës parti të përfaqësuar në Kuvend. Në mënyrë, megjithatë, që të sigurohet barazia e mundësive për forcat e ndryshme politike, financimi publik mund të shtrihet gjithashtu në subjektet politike që përfaqësojnë një pjesë domethënëse të trupës zgjedhore dhe që paraqet kandidatë për zgjedhje dhe se niveli i financimit mund të përcaktohet nga ligjvënësi mbi një bazë periodike, bazuar në kritere objektive.

27. Gjykata vëren se, edhe pse në parim mbështetja financiare e shtetit ndaj partive politike ka rëndësi në një shtet të së drejtës, kjo megjithatë nuk nënkupton që ajo nuk ka kufij, ajo nuk mund të tejkalojë një masë që respekton parimin e ndarjes së partive politike nga shteti. Gjykata vlerëson se kjo mbështetje financiare e shtetit mund të kufizohet mbi bazën e kontributit të partive politike, duke e vlerësuar atë në termat e “*seriozitetit të përpjekjeve të partive konkurruese*” ose të “*seriozitetit të qëllimeve elektorale të partive*” që shpreh një shkallë të përfaqësimit të tyre. Qëllimi i financimit nuk mund të jetë kufizimi i konkurrencës të lirë por ai duhet të sigurojë seriozitetin e kësaj gare. Ai nuk është një instrument për integrimin e partive politike, por thjesht një përcaktues i faktit nëse programet zgjedhore kanë pasur qëllime serioze, nëse ato janë orientuar ekskluzivisht drejt suksesit të zgjedhjeve dhe jo ndaj qëllimeve të tjera (*shih vendimet Pl. US 30/98, datë 13.10.1999; Pl. US 42/00, datë 24.01.2001; Pl. US 10/03, datë 19.01.2005 të Gjykatës Kushtetuese të Çekisë*).

28. Siç u theksua edhe më sipër në këtë vendim, ligjvënësi ka hapësirë për të parashikuar në ligj kritere të tilla që i përgjigjen në realitet dhe objektivisht parimit të barazisë së votave dhe përfaqësimit të barabartë, por çfarëdolloj ndërhyrjeje nga ligjvënësi duhet të udhëhiqet nga interesi publik. Ligjvënësi, kur rregullon fushën e krijimit të vullnetit politik, duhet të mbajë parasysh faktin se në këtë fushë kufijtë e hapësirës së tij të veprimit janë më të ngushtë dhe se nuk pranohet një trajtim i diferencuar i partive që nuk mbështetet në baza veçanërisht serioze. Gjykata vlerëson se zgjedhjet kanë si objektiv të mundësojnë zgjedhësit të zgjedhin përfaqësuesit e tyre, por edhe të sjellin në Kuvend një shumicë të qëndrueshme, që në vijim të mund të prodhojë legjislacion dhe të mundësojë një qeverisje efektive. Një sistem proporcional, tërësisht i pakufizuar përballë partive të vogla, mund të ketë, potencialisht, pasoja destabilizuese. Trajtimi i pabarabartë i partive, duke dalluar ndërmjet tyre partitë brenda dhe jashtë Kuvendit, bëhet për mbrojtjen e votuesit nga shpërdorimi i votës. Gjykata vlerëson se është një vullnet i ligjshëm i ligjvënësit të kërkojë mbrojtjen e votuesit, në mënyrë që ai të mos ia japë votën një kandidati ose oferte të pashpresë. Një sistem zgjedhor që mundëson oferta zgjedhore mund të funksionojë vetëm nëse paraqitja e një oferte nuk është thjesht e drejta e gjithkujt, pa asnjë përgjegjësi të mëtejshme. Vetëm një ofertë që merret seriozisht është një ofertë me kuptim (*shih vendimin nr.32, datë 21.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Gjykata vëren se shpërndarja e fondeve sipas parashikimit të nenit 87 të Kodit Zgjedhor de facto kufizon partitë e reja, që marrin pjesë për herë të parë në zgjedhje, apo partitë e vogla që nuk kanë arritur të sigurojnë mjaftueshëm vota në zgjedhjet pararendëse për të siguruar vende në Kuvend dhe paraqet avantazhe financiare për partitë që përfaqësohen me deputetë në Kuvend. Për këtë arsye, është e nevojshme të shqyrtohet me kujdes nëse një parashikim i tillë udhëhiqet nga interesi publik.

30. Gjykata thekson se është e drejtë e ligjvënësit të përcaktojë me ligj sasinë e buxhetit të shtetit që do të ketë destinacion financimin e partive politike. Ligjvënësi e ka lidhur shpërndarjen e këtyre fondeve me rezultatin e zgjedhjeve dhe numrin e mandateve përfaqësuese në Kuvend, sepse kjo reflekton pozicionin real të një partie politike dhe veçanërisht shkallën e pjesëmarrjes në pushtetin legjislativ. Ky është një kriter i mjaftueshëm për të ndarë partitë politike në ato që kanë një domethënie reale për veprimtarinë politike në vend, bazuar në vullnetin e votuesve që ato përfaqësojnë, dhe në ato që nuk arrijnë të përfaqësojnë një pjesë domethënëse të zgjedhësve duke rezultuar të pasuksesshme në zgjedhje. Ky parashikim ka si qëllim të kufizojë ekzistencën e entiteteve që marrin pjesë në zgjedhje kryesisht me qëllimin për të përfituar fonde nga buxheti i shtetit por që nuk kanë një influencë reale në jetën politike të vendit dhe as një mbështetje domethënëse nga zgjedhësit. Gjykata vlerëson se kufizimet e parashikuara nga neni 87 i Kodit Zgjedhor, për përfitimin e financimit nga buxheti i shtetit përbëjnë, në vlerësimin e saj, provë të mjaftueshme të seriozitetit të përpjekjeve të këtyre partive në konkurrimin zgjedhor. Partitë politike kryejnë funksionin e përfaqësimit të interesave të ndryshme dhe synojnë realizimin/përmbushjen e këtyre interesave përmes mjeteve demokratike, pra përmes përfaqësimit në asamblatë përfaqësuese. Ato parti që nuk marrin pjesë në zgjedhje, ose nuk marrin mjaftueshëm mbështetje publike, qartësisht nuk japin të njëjtin kontribut në përcaktimin e vullnetit politik të popullit. Gjykata vëren se një rregullim i tillë do të konsiderohej jokushtetues vetëm në rast se nuk do të ekzistonte një lidhje racionale ndërmjet këtij rregullimi ligjor dhe qëllimit që ai kërkon të arrijë. Financimi i shtetit për partitë politike shtrihet ndaj të gjitha partive politike që duke marrë një numër të konsiderueshëm votash, i përkthyer më pas në mandate, që tregojnë mbështetjen e një mase zgjedhësish aktivë, arrijnë të tregojnë se plotësojnë kushtin e “*seriozitetit të përpjekjeve të partive konkurruese*” ose të “*seriozitetit të qëllimeve elektorale të partive*” për të marrë pjesë në konkurrimin elektorale.

Për këto arsye, Gjykata vlerëson se parashikimi i nenit 87 të Kodit Zgjedhor, nuk bie në kundërshtim me parimin e barazisë së partive politike përballë shtetit dhe as me parimin e shanseve të barabarta në konkurrimin politik.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “a”, 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e pikave 4 dhe 6 të nenit 70 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. (votuan kundër gjyqtarët V. Kristo dhe F. Hoxha)
3. Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të nenit 87 të Kodit Zgjedhor (votuan kundër gjyqtarët P. Ploçi dhe S. Berberi).
4. Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo, Petrit Ploçi, Xhezair Zaganjori, Fatmir Hoxha, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza.



MENDIM PAKICE

Ne, gjyqtarët në pakicë, jemi kundër vendimit të shumicës, vetëm për pjesën që ka rrëzuar pretendimin e kërkuarit për shfuqizimin e nenit 87 të Kodit Zgjedhor (KZ), që parashikon shpërndarjen dhe rishpërndarjen e fondeve publike për subjektet zgjedhore.

Shumica në këtë çështje ka vlerësuar se parashikimi i nenit 87 të KZ-së, nuk bie në kundërshtim me parimin e barazisë së partive politike përballë shtetit dhe as me parimin e shanseve të barabarta në konkurrimin politik. Pakica ndan një mendim të ndryshëm nga shumica për arsyet që shtjellohen në vijim.

Parimi i konkurrimit të lirë të partive politike, siç ka theksuar dhe shumica, përfshin detyrimin e shtetit për të respektuar shanset e barabarta të të gjitha partive dhe ndalon ligjvënësin të trajtojë palët në mënyrë të dallueshme nga njëra-tjetra, përveçse kur ekzistojnë arsye të forta përjashtimore për ta bërë këtë. Konkurrimi i lirë ndërmjet partive është një shfaqje e drejtpërdrejtë e natyrës pluraliste të shoqërisë demokratike dhe çdo kufizim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë mbi barazinë e partive në konkurrimin zgjedhor nuk duhet të ketë një pasojë diferencuese ose të përbëjë një trajtim preferencial për disa parti, ose të ndalojë pjesëmarrjen e partive politike në konkurrimin zgjedhor (*shih vendimin nr. 32, datë 21.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

Në vendimin e sipërcituar, Gjykata është shprehur se parimi i barazisë së të drejtës për t'u votuar/zgjedhur ndalon shtetin të diskriminojë ose të privilegjojë kandidatë të caktuar, parti politike ose grupe të tjera politike në përballjen konkurruese për të tërhequr votën e zgjedhësit. Midis partive duhet të krijohen shanse të barabarta dhe shteti duhet të jetë i paanshëm ndaj tyre. Në veçanti kërkesa për asnjësi zbatohet për fushatën zgjedhore, mbulimin nga media, si dhe për financimin publik të partive dhe fushatave. Në varësi të objektit, barazia mund të jetë strikte ose proporcionale. Në rast se është strikte, partitë politike trajtohen në mënyrë të barabartë, pavarësisht nga fuqia e tyre parlamentare aktuale ose mbështetja nga elektorati. Në rast se është proporcionale, partitë politike duhet të trajtohen në bazë të rezultateve të arritura në zgjedhjet Pakica çmon se nëse konkurrimi i lirë, në kushte të barabarta, i partive politike që marrin pjesë në garën elektorale nuk sigurohet, nëse krijohet një situatë ligjore që lejon partitë e mëdha ose më të mëdha, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, të trajtohen në mënyrë të diferencuar, dispozitat që parashikojnë një gjë të tillë nuk mund të konsiderohen si kushtetuese. Parimi i konkurrimit të lirë të partive politike kërkon që ligjvënësi të marrë masa për të siguruar barazinë maksimale mes partive politike, duke siguruar konkurrimin e tyre të lirë dhe të ndershëm, hapjen e sistemit politik, si dhe mundësinë për të hyrë në skenën politike të entiteteve të reja. Duke iu referuar parimit të barazisë proporcionale, fondet publike duhet të akordohen sipas niveleve të mbështetjes popullore ndaj partive politike, zakonisht e matur në proporcion me numrin e votave për parti apo kandidat në zgjedhjet e përgjithshme legjislative, dhe/ose me numrin e vendeve që përftohen në parlament. Ndërsa barazia strikte kërkon që çdo parti ose kandidat të marrë një shumë të barabartë parash, ose një shumë të përgjithshme, pavarësisht nga mbështetja elektorale apo numri i vendeve/mandateve në parlament.

Sipas nenit 87 të KZ-së, që i referohet shpërndarjes së fondeve për financimin e fushatës zgjedhore të parashikuara në buxhetin e vitit kur do të zhvillohen zgjedhje, sasia e fondeve publike që i shpërndahet secilit prej subjekteve zgjedhore caktohet me vendim të KQZ-së, sipas rregullave të mëposhtme:

a) 50 për qind e shumës ndahet ndërmjet partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore dhe që kanë mandate në Kuvend, (...) Shuma shpërndahet mbi bazën e numrit të mandateve të fituara në zgjedhjet për Kuvendin;

b) 50 për qind e shumës së përgjithshme ndahet midis partive politike të regjistruara si subjekt zgjedhor dhe që në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin kanë marrë jo më pak se 2 vende në Kuvend, (...)

Bazuar në përmbajtjen e nenit 87 të KZ-së, konstatohet se ligjvënësi shqiptar, në lidhje me shpërndarjen e fondeve publike për mbështetjen e fushatës zgjedhore, ka zbatuar parimin e proporcionalitetit, pra shpërndarjen e tyre në përputhje me mbështetjen popullore, të reflektuar në mandate, që gëzojnë partitë politike.

Nga interpretimi literal dhe sistematik i paragrafëve “a” dhe “b” të kësaj dispozite, kriteri që duhet të përmbushin partitë politike, të regjistruara si subjekte zgjedhore, për të përfituar nga fondet publike është të kenë mandate në Kuvend. Kjo nënkupton se vetëm partitë politike që janë pjesë e Kuvendit, pra janë parti parlamentare, mund të përfitojnë financim nga fondet publike. Sipas paragrafit “a” mjafton pasja qoftë dhe vetëm e një mandati në Kuvend për të gëzuar të drejtën e përfitimit të fondeve publike. Numri i mandateve shërben thjesht dhe vetëm si bazë për shpërndarjen proporcionale të 50% të shumës totale të fondeve ndërmjet partive parlamentare. Paragrafi “b” e lidh marrjen e fondeve publike me një tjetër kriter, atë të arritjes së pragut prej të paktën dy mandatesh në Kuvend. Partitë politike, të regjistruara si subjekte zgjedhore, të cilat kanë të paktën 2 mandate në Kuvend përfitojnë 50% të shumës së përgjithshme të fondeve publike. Pavarësisht se mënyra e shpërndarjes së fondeve publike është parashikuar e ndarë në dy paragrafë, rregullimet që përmbajnë këta paragrafë të çojnë në thelb në të njëjtin rezultat; vetëm partitë parlamentare përfitojnë nga fondet publike gjatë fushatës zgjedhore. Rrjedhimisht, partitë politike, të cilat nuk kanë arritur pragun minimal të pasjes së një mandati në Kuvend në zgjedhjet paraardhëse si dhe partitë e reja të krijuara pas këtyre zgjedhjeve, janë të përjashtuara *a priori* nga skema e financimit me fonde publike të përcaktuar nga neni 87 i KZ-së. Për këto dy kategori partish politike nuk parashikohet asnjë kriter për akordimin e fondeve publike gjatë fushatës zgjedhore. Pakica vlerëson se kriteri që lidh përfitimin e fondeve publike gjatë fushatës zgjedhore me pasjen e një mandati në Kuvend, duke përjashtuar nga skema e këtij financimi partitë që nuk kanë fituar asnjë mandat në zgjedhjet pararendëse dhe partitë e reja të krijuara pas zgjedhjeve, nuk është proporcional dhe si i tillë cenon barazinë gjatë zgjedhjeve parlamentare në lidhje me financimin publik. Ky qëndrim mbështetet në argumentet që vijojnë.

Pakica është dakord me mendimin e shumicës, sipas të cilit është e drejtë e ligjvënësit të përcaktojë me ligj jo vetëm sasinë e buxhetit të destinuar për financimin e partive politike, por edhe kriteret e diferencuara mbi bazën e të cilave ai do të shpërndahet. Megjithatë, duke pasur parasysh qëllimin për të cilin ky buxhet caktohet dhe shpërndahet (financimi i fushatës zgjedhore) pakica vlerëson se është thelbësore që këto kriteret të jenë objektive, proporcionale, të drejta e të arsyeshme, si dhe të sigurojnë shanse të barabarta për të gjitha partitë politike, në mënyrë që ato të konkurrojnë në kushte të barabarta. Sistemet e financimit të përzgjedhura nga ligjvënësi duhet të synojnë të parashikojnë, për të gjitha partitë, mundësi për të konkurruar në zgjedhje, në përputhje me parimin e mundësive të barabarta.

Hapja e sistemit politik është e lidhur, mes të tjerash, edhe me formimin e një sistemi të përshtatshëm për financimin e partive politike. Koncepti i përfaqësimit proporcional kuptohet përgjithësisht që zgjedhjet do të transferojnë në mënyrë proporcionale në Parlament një shpërndarje politike, e cila korrespondon me sa votues kanë votuar dhe rezultati i të cilit është zakonisht një parlament me parti politike të ndryshme dhe një qeveri koalicioni. Avantazhet e sistemit proporcional përfshijnë, mes të tjerash, lejimin e përfaqësimit maksimal të të gjitha opinionëve dhe interesave në parlament dhe mbështet formimin e një shumice mbi bazën e negociatave dhe kompromiseve. Një ndërhyrje e ligjvënësit, nëpërmjet stimuljeve integruar, do të konsiderohet kushtetuese nëse ajo zbatohet vetëm për qëllimin e formimit të vullnetit politik të popullit, pra formimin e një shumice vendimmarrëse. Pakica vlerëson se, financimi i fushatës zgjedhore duhet të ketë si qëllim financimin e të gjitha partive politike që marrin pjesë në garën elektorale dhe një kusht për kushtetutshmërinë e tij është sigurimi i hapjes së sistemit politik, prandaj pragu për të përfituar financimin duhet të jetë në mënyrë domethënëse më i ulët se pragu i sistemit zgjedhor proporcional.

Për sa më sipër, pakica vlerëson se në rast të zbatimit të barazisë proporcionale, për



shpërndarjen e fondeve publike, gjithashtu niveli i mbështetjes politike duhet të llogaritet në bazë të kriterëve objektive. Ligjvënësi duhet të parashikojë një prag minimal mbështetjeje për përfitimin e financimeve, i cili duhet të jetë më i ulët se ai i nevojshëm për caktimin e një mandati në parlament, pasi një prag i lartë i paarsyeshëm devijon pluralizmin politik dhe dëmton partitë e vogla politike. Në këtë aspekt mund të parashikohet për shembull një kriter i llojit politik, sipas numrit të mbështetësve të partisë politike përkatëse. Kërkesa për përfitimin e financimeve në bazë të numrit të mandateve, shpërfill kriterin e mbështetjes elektorale të partive pjesëmarrëse në garë dhe bën që fondet publike të përqendrohen vetëm në duart e partive parlamentare, duke mbartur rrezikun e krijimit të një monopolizimi të këtyre fondeve. Përqendrimi i mbështetjes financiare të shtetit për vetëm disa parti, ato parlamentare, është de facto një penalizim financiar për partitë e tjera më të vogla apo dhe partitë e reja. Për këtë arsye është e nevojshme të shqyrtohet me kujdes nëse qëllimi i masave të tilla është tejkaluar nga ligjvënësi. Ky qëllim, ashtu siç shprehet edhe shumica, duhet të jetë vetëm serioziteti i përpjekjes të partive konkurruese, i cili nuk synon të arrijë asgjë tjetër veç pjesëmarrjes në përfaqësimin politik të vendit dhe promovimin e programeve të tyre.

Kuadri ligjor që penalizon ato parti politike që duan të integrohen, kufizon konkurrimin e lirë të tyre. Kriteri bazë i kushtetutshmërisë, kur përcaktohet një prag minimal për pagesat për veprimtarinë e partive politike, qëndron në sigurimin e hapjes së sistemit politik, prandaj pragu duhet të jetë më i ulët se sa pragu mbyllës në sistemin proporcional për të përfituar një mandat. Gjykata Kushtetuese çeke i ka analizuar këta kufij në termat e dy parimeve: atë të integritimit (*integration*) dhe atë të përfaqësimit (*representativeness*). Parimi i përfaqësimit do të thotë, mbi të gjitha, që përbërja e një organi përfaqësues rrjedh nga struktura politike e një shoqërie civile, megjithatë ai, gjithashtu, përfshin kërkesën për një përfaqësim minimal të entiteteve (parti dhe lëvizje politike) që marrin pjesë në një garë elektorale. Në vendimin e saj nr.PI. US 30/98 Gjykata Kushtetuese çeke shfuqizoi kushtin e marrjes së të paktën 3% të numrit total të votave të vlefshme, me qëllim të përfitimit të financimit për mbulimin e shpenzimeve zgjedhore. Ajo ka vlerësuar se lidhja e përfitimit të financimit me marrjen e 3% të numrit total të votave të vlefshme në zgjedhje, tejkalon kufirin e nevojshëm për të përcaktuar seriozitetin e qëllimeve elektorale të partive dhe ndërhyr në barazinë e mundësive të partive politike në konkurrimin zgjedhor. Në vendimin nr. 2005/01/19 - PI. ÚS 10/03, Gjykata Kushtetuese çeke ka pohuar se në kuadrin e parimit të demokracisë përfaqësuese, është e lejueshme të ndërtohen në vetë mekanizmin elektorale disa stimuluj integruar atje ku ka arsye serioze për këtë, veçanërisht bazuar në supozimin se një sistem proporcional i pakufizuar do të çonte në fragmentimin e votave ndërmjet një numri të madh partish politike, në një “mbipopullim” të partive politike dhe, si pasojë, në një rrezik në funksionimin e sistemit parlamentar. Kur vlerësohen kufijtë e pranueshmërisë së stimujve integruar, fillohet me parimin e proporcionalitetit në mënyrë që të sigurohet formimi i një shumice parlamentare, e nevojshme për marrjen e vendimeve dhe krijimin e qeverisë. Rritja e pragut hyrës nuk mund të rrezikojë substancën demokratike të zgjedhjeve.

Siç shihet qartë, Gjykata Kushtetuese çeke, në çështjet e financimit publik të partive politike, në konfliktin mes parimit të integritimit dhe atij të pluralizmit në një shoqëri demokratike, i ka dhënë prioritet këtij të fundit, duke konsideruar dispozitën që kushtëzonte financimin me arritjen e një pragu mbyllës në zgjedhjet elektorale si jokushtetuese. Ajo e ka lidhur hapjen e sistemit politik me një kufi më të ulët për të përfituar kontributin se sa ai për të marrë një vend në parlament.

Po kështu, në këtë drejtim mund të përmendim vendimin nr. 89-271 DC/1990 të Këshilli Kushtetues Francez, i cili ka deklaruar se lidhja e kontributit elektorale me përfitimin e më shumë se 5% të votave në distrikte individuale ishte jokushtetuese dhe në kundërshtim me parimin e barazisë. Në Gjermani marrja e 0.5% të votave në zgjedhjet elektorale është e mjaftueshme për përfitimin e financimeve nga buxheti i shtetit, për të mundësuar ushtrimin nga partitë të funksioneve të tyre kushtetuese, njëra prej të cilave është dhe pjesëmarrja në zgjedhje.

Sipas opinionit të përbashkët të Komisionit të Venecias dhe OSBE/ODHIR për Kodin tonë Zgjedhor (Opinionit nr.513/2009 CDL-AD(2009)005, Venice 13-14 mars 2009), përmbajtja e nenit 87 të Kodit nënkupton që vetëm partitë parlamentare përfitojnë fonde publike për zgjedhjet dhe se është e diskutueshme nëse partitë politike në Kuvend ia japin të gjitha fondet publike për fushatën elektorale vetes së tyre. Komisioni i Venecias dhe OSBE/ODHIR rekomandojnë që këto dispozita të amendohen për të parashikuar mekanizma edhe për financimin publik të partive jo-parlamentare.

Nisur nga sa më lart, pakica çmon se, neni 87 i Kodit Zgjedhor, në thelb, duke parashikuar dhënien e financimit vetëm në bazë të mandateve të fituara, mbështet partitë e mëdha të stabilizuara tashmë, në kurriz të partive të reja apo dhe atyre të vogla që nuk kanë fituar mjaftueshëm vota për të siguruar një mandat në parlament. Në vlerësimin tonë ky parashikim cenon parimin e pjesëmarrjes së barabartë të partive politike në konkurrimin zgjedhor dhe parimin e proporcionalitetit. Nëse rregullimet ligjore nuk respektojnë konkurrimin e lirë të partive politike në kushte të njëjta dhe nuk përcaktojnë kritere proporcionale për financimin publik të partive politike gjatë fushatës zgjedhore, duke krijuar situata të favorshme për disa parti dhe jo të favorshme për disa të tjera, këto rregullime nuk mund të konsiderohen kushtetuese.

Si përfundim, në kuptim të arsyetimit të mësipërm, pakica vlerëson se përmbajtja e nenit 87, pika 2, e Kodit Zgjedhor paraqet probleme kushtetutshmërie dhe për këto arsye duhej të ishte pranuar kërkesa edhe për këtë pjesë dhe duhej të ishte vendosur shfuqizimi i kësaj dispozite.

Anëtarë: Sokol Berberi, Petrit Ploçi

VENDIM
Nr. 29, datë 15.5.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Ploçi	Anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar	i	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 07.02.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 58/33 Akti, që i përket:

KËRKUES: Reshit Uku

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës të Shqipërisë, i vendimit nr.577, datë 4.11.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe vendimit unifikues nr.5, datë 15.9.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.



GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Altina Xhoxhaj, shqyrtoi çështjen mbi aktet dhe diskutoi për të në tërësi,

VËREN:

I

1. Mbi bazën e kallëzimit të kërkuarit Reshit Uku, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë ka regjistruar procedimin penal në ngarkim të Kryetarit të Komisionit të Ndarjes së Tokës në fshatin Lekaj dhe Kryetarit të Komunës Lekaj, Kavajë, për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

2. Me vendimin nr.122, datë 30.01.2006, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë ka vendosur pushimin e këtij procedimi penal. Kundër këtij vendimi kërkuar ka paraqitur ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

3. Me vendimin nr.41, datë 07.06.2006, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka vendosur rrëzimin e ankimit të kërkuarit, për kundërshtimin e vendimit nr.122, datë 30.01.2006 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, si të pabazuar në prova dhe në ligj.

4. Me vendimin nr.50, datë 05.12.2006, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.41, datë 07.06.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Kundër këtij vendimi kërkuar ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

5. Me vendimin nr.577, datë 04.11.2009, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në seancë gjyqësore, bazuar në nenin 435/2 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe në interpretimin që i është bërë kësaj dispozite me vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.5, datë 15.09.2009, ka vendosur mospranimin e rekursit për mungesë të nënshkrimit të tij nga mbrojtësi i kërkuarit.

6. **Kërkuar** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë duke parashtruar, në thelb, se:

- Baza ligjore në të cilën është mbështetur Gjykata e Lartë, nenet 420/c dhe 435/2 të KPP-së, janë keqkuptuar dhe keqinterpretuar prej saj. Pozita e kërkuarit në këtë proces nuk ka qenë ajo e të pandehurit, për të cilin kërkohet mbrojtja ligjore dhe, për pasojë, edhe nënshkrimi i rekursit nga mbrojtësi. Pozita e kërkuarit ka qenë ajo e kallëzuesit, për të cilin nuk është e nevojshme as mbrojtja ligjore dhe as nënshkrimi i rekursit nga mbrojtësi.

II

A. Lidhur me legjitimitimin e kërkuarit

7. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) vëren se kërkuar legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 131, shkronja "f", të Kushtetutës.

8. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, Gjykata vëren se ligji nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", në nenin 30, ka parashikuar një afat 2-vjeçar për t'iu drejtuar kësaj Gjykate për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Nga materialet bashkëlidhur kërkesës rezulton se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë mban datën 04.11.2009, ndërkohë që në zarin me të cilin është dërguar kërkesa në Gjykatë konstatohet se vula postare mban datën 05.11.2011. Pavarësisht datës së shënuar në zarf mbrojtësi i kërkuarit pretendoi se ajo është paraqitur pranë zyrës postare në datën 04.11.2011, pra brenda afatit ligjor të ankimit. Për këtë qëllim, me shkresën nr.R-5 akti, datë 09.10.2011, Gjykata i është drejtuar Postës Shqiptare për t'iu informuar lidhur me datën e saktë të postimit të kësaj kërkesë. Me shkresën nr.2139/1 prot., datë 14.11.2011, Posta Shqiptare ka informuar se kërkesa 2898

është paraqitur në zyrën postare pranë Institutit Bujqësor Kamëz, Tiranë, në datën 05.11.2011 dhe po në këtë datë ajo është dërguar në degën e shpërndarjes për t'u dërguar më pas në destinacion. Bashkëlidhur kësaj shkrese ajo ka dërguar edhe fotokopje të dëftesës së pranimit dhe listë dërgesës në degët e shpërndarjes. Ndërkohë, kërkuesi ka paraqitur pranë Gjykatës një dëftesë për pranimin e objekteve postare, me të cilën është pajisur nga vetë zyra postare ku ka bërë dorëzimin e zarfit drejtuar Gjykatës, e cila mban datën 04.11.2011 dhe në të gjenden edhe vulat e kësaj zyre postare, të cilat po ashtu kanë datën 04.11.2011. Për sa më sipër, duke qenë se kërkuesi, të cilit i takon barra e provës për të provuar pretendimin e tij, e ka përmbushur këtë detyrim dhe ka provuar se ai e ka depozituar kërkesën pranë zyrës postare në datën 04.11.2011, Gjykata vlerëson se kërkesa e tij është paraqitur brenda afatit ligjor 2-vjeçar dhe, në këto kushte, ai legjitimohet edhe *ratione temporis*.

9. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi, në thelb, pretendon cenimin e të drejtës për proces të rregullt ligjor si pasojë e mospranimit për shqyrtim në seancë gjyqësore të rekursit të tij, për pasojë të mungesës së nënshkrimit të tij nga mbrojtësi. Në rastet kur Gjykata e Lartë ka vendosur, në Dhomë Këshillimi, mospranimin e rekursit për shkak të mungesës së nënshkrimit nga mbrojtësi, në kuptim të nenit 435/2 të KPP-së, Gjykata i ka trajtuar këto kategori çështjesh në këndvështrim të respektimit të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës (aksesit në gjykatë). Ajo ka theksuar se e drejta e individit për t'iu drejtuar gjykatës, si një nga elementet e procesit të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, nuk përfshin vetëm të drejtën për të hapur një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare në lidhje me mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj lidhur me pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr.38, datë 30.12.2010; nr.5, datë 2.03.2011; nr.8, datë 16.03.2011; nr.9, datë 29.03.2011; nr.10, datë 29.03.2011; nr.46, datë 04.11.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata ka theksuar se përdorimi i mjetit procedural të përshtatshëm ankimes, në formë e në përmbajtje, siç është sanksionuar në KPP, nuk përbën një kërkesë formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e të drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Trajtimi i mjetit procedural në mënyrë josubstanciale cenon të drejtën e mbrojtjes të të gjykuarit dhe njëkohësisht aksesin e tij në Gjykatën e Lartë (*shih vendimet nr.38, datë 30.12.2010; nr.5, datë 02.03.2011; nr.8, datë 16.03.2011; nr.9, datë 29.03.2011; nr.10, datë 29.03.2011; nr.26, datë 13.06.2011; nr.37, datë 19.09.2011; nr.39, datë 21.09.2011; nr.41, datë 28.09.2011; nr.46, datë 04.11.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në vështrim të garantimit të standardit të aksesit në gjykatë, Gjykata ka vlerësuar se neni 435/2 i KPP-së është interpretuar nga Gjykata e Lartë në një mënyrë të tillë (*stricto sensu*), që cenon thelbin e të drejtës së individit për t'iu drejtuar asaj gjykate. Ajo ka theksuar se zbatimi i nenit 435/2 të KPP-së duhet parë në raport me rregullimet e përgjithshme të këtij Kodi që disiplinon paraqitjen e ankimit, si dhe ato të veçanta për paraqitjen e rekursi. Në situatën në të cilën individit ka ushtruar rekursin, në përmbushje të detyrimeve të tij formale që përcaktohen kryesisht në nenet 410, 412, 420, 435/1 të KPP-së, ai nuk mund të privohet nga e drejta që pretendimet e ngritura në rekurs të vlerësohen sipas përcaktimeve të nenit 432 të KPP-së (*shih vendimin nr.38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Çdo interpretim i ndryshëm, që mund t'i bëhet përmbajtjes së nenit 435/2 të KPP-së, nuk i shërben garantimit të standardeve për një proces të rregullt ligjor.

11. Gjykata konstaton se në çështjen në shqyrtim, bazuar në vendimin nr.577, datë 04.11.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, elementet formale të rekursit janë verifikuar në seancë gjyqësore ku, pasi është dëgjuar prokurori i çështjes (që ka kërkuar mospranimin e ankimit) dhe mbrojtësi i kërkesit (që ka kërkuar vazhdimin e gjykimit), Kolegji Penal ka vlerësuar se rekursi nuk ka respektuar dispozitat që lidhen me formën (nuk është i firmosur nga mbrojtësi) dhe ka vendosur mospranimin e tij.



12. Bazuar në nenin 42/2 të Kushtetutës, çdo individ, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Gjykata vëren se e drejta për një proces të rregullt ligjor është një e drejtë kushtetuese e individëve, nëpërmjet të cilës ata kërkojnë realizimin e procedurave të drejta dhe të ndershme ligjore. E drejta e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës shfaqet si një e drejtë që garanton zhvillimin e një procesi të rregullt, nga pikëpamja e rregullshmërisë së procedurave, proces nëpërmjet të cilit individ i kërkon mbrojtjen e një të drejte thelbësore. Gjykata konstaton se kërkuesi Reshit Uku, duke pretenduar se është cenuar në të drejtën e tij të pronësisë, për shkak të mospajisjes së tij me një sipërfaqe toke bujqësore, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, dhe me qëllim të mbrojtjes së kësaj të drejte, mes të tjerash, ka paraqitur edhe kallëzim penal kundër shtetasve N.H. dhe Z.M., për kryerjen e veprave penale të shpërdorimit të detyrës dhe falsifikimit të dokumenteve, duke pretenduar se këta persona, përkatësisht në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Ndarjes së Tokës në fshatin Lekaj dhe Kryetarit të Komunës Lekaj, Kavajë, kanë pajisur me tokë bujqësore në pronësi, në kundërshtim me ligjin për tokën, shtetasin R.K. Kallëzimi i parë i kërkuesit është ai i datës 02.08.2005, në lidhje me të cilin organi i akuzës, me vendimin nr.122, datë 30.01.2006, ka vendosur pushimin e procedimit penal, vendim i cili është ankimuar nga kërkuesi në të tri shkallët e gjykitimit. Është pikërisht ky proces që është kundërshtuar nga kërkuesi si jokushtetues dhe është objekt i këtij gjykimi kushtetues. Nga materialet bashkëlidhur kërkesës rezulton, gjithashtu, se kërkuesi ka paraqitur përsëri kallëzim pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, në datën 02.04.2008, kundër të njëjtëve shtetas dhe për kryerjen e të njëjtave vepra penale. Në bazë të këtij kallëzimi, prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, ka vendosur të dërgojë për gjykim çështjen penale në ngarkim të këtyre shtetasve dhe pas gjykitimit të kësaj çështjeje rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr.116, datë 23.11.2009, ka vendosur deklarimin e tyre fajtor për kryerjen e veprës penale të “shpërdorimit të detyrës” dhe dënimin e tyre, përkatësisht, shtetasin N.H. me gjashtë muaj burgim dhe katërqind mijë lekë gjobë, dhe shtetasin Z.M. me tetë muaj burgim dhe katërqind mijë lekë gjobë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.10-2011-152 (50), datë 02.02.2011.

13. Gjykata ka vlerësuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në aspektin kushtetues dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr.21, datë 01.10.2008; nr.40, datë 22.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe pse Gjykata vlerëson se, bazuar në jurisprudencën e saj në çështje të ngjashme, procesi i zhvilluar në Gjykatën e Lartë paraqet probleme kushtetutshmërie, për shkak të vendimit të marrë në seancë gjyqësore për mospranimin e rekursit si të pafirmosur nga mbrojtësi, ajo vlerëson, gjithashtu, se cenimi i këtij procesi do të sillte si pasojë shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve gjyqësore që nuk kanë pranuar ankimin ndaj vendimit të prokurorit për pushimin e çështjes penale. Ndërkohë, Gjykata vlerëson se e drejta e kërkuesit për të pasur një gjykim përfundimtar lidhur me kallëzimin penal ndaj personave të akuzuar është garantuar edhe pse në një proces tjetër, të ndryshëm nga ai në shqyrtim, por i iniciuar për të njëjtat shkaqe dhe kundër të njëjtëve individë.

Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi Reshit Uku duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Petrit Ploçi, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza, Fatmir Hoxha.

VENDIM
Nr.30, datë 16.5.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Petrit Ploçi	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 16.02.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr.1 Akti, që i përket:

KËRKUES: Besim Ziri, Petrit Ziri

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Zyra Përmbartimore Krujë, Zyra Përmbartimore Durrës, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Krujë, komisioni vendor i verifikimit të titujve të pronësisë, pranë prefektit të qarkut Durrës.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Altina Xhoxhaj, shqyrtoi çështjen mbi aktet dhe diskutoi për të në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesit Besim Ziri dhe Petrit Ziri janë banorë të qytetit të Fushë-Krujës. Në bazë të ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, secili prej tyre është pajisur me tokë bujqësore. Për këtë qëllim, Komisioni i Ndarjes së Tokës (KNT) pranë bashkisë Fushë-Krujë ka lëshuar fillimisht formularin nr.6 ku evidentohet numri kadastral i parcelës, sipërfaqja e saj dhe emri i personit që e merr në pronësi. Sipas këtij formulari kërkuesit janë pajisur, përkatësisht, kërkuesi Besim Ziri me parcelën nr.88/2 dhe kërkuesi Petrit Ziri me parcelën nr.88/1. Më pas KNT-ja Krujë ka lëshuar edhe aktet e marrjes së tokës në pronësi në të cilat pasuritë që u janë dhënë kërkuesve rezultojnë të



korrigjuara, dhe pra të ndryshme nga ato që pasqyrohen në formularin nr.6. Më konkretisht, sipas akteve bashkëlidhur kërkesës, parcela që i ishte njohur kërkuarit Besim Ziri rezultoi e korrigjuar (e fshirë) kurse kërkuarit Petrit Ziri i është njohur në pronësi parcela nr.88/2.

2. Në vitin 2001, kërkuarit i janë drejtuar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Krujë për t'u pajisur me vërtetim pronësie, por ky vërtetim nuk u është lëshuar pasi pasuritë përkatëse rezultoi në regjistruara në emër të personave të tretë.

3. Kërkuarit i janë drejtuar KNT-së Krujë me kërkesë për lëshimin e një kopjeje zyrtare të aktit të marrjes së tokës në pronësi, kërkesë e cila u është refuzuar.

4. Në këto kushte, kërkuarit i janë drejtuar gjykatës me padi të veçanta, me objekt detyrimin e KNT-së pranë Bashkisë Fushë-Krujë t'i pajisë ata me aktin e marrjes së tokës në pronësi, sipas formularit nr.6.

5. Me vendimet nr.558, datë 08.10.2008 dhe nr.559, datë 08.10.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka vendosur pranimin e kërkesëpadive dhe detyrimin e palës së paditur KNT-së pranë bashkisë Fushë-Krujë të pajisë kërkuarit me aktin e marrjes së tokës në pronësi sipas formularit nr.6. Këto vendime kanë marrë formë të prerë.

6. Me vendimet nr.91, datë 03.05.2010 dhe nr.92, datë 03.05.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka lëshuar urdhrat e ekzekutimit të vendimeve të mësipërme të formës së prerë.

7. Me shkresën e datës 18.05.2010, Zyra Përbarimore Krujë i është drejtuar KNT-së pranë bashkisë Krujë për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë të gjykatave.

8. Me vendimin e datës 04.06.2010, çështja përbarimore i është transferuar, për kompetencë territoriale, Zyrës Përbarimore Durrës, për arsye se me hyrjen në fuqi të ligjit nr.9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", kompetencat e KNT-së pranë bashkisë Fushë-Krujë i kanë kaluar Komisionit Vendor të Verifikimit të Titujve të Pronësisë (KV) pranë Prefektit të Qarkut Durrës.

9. Me shkresën e datës 17.06.2010, Zyra Përbarimore Durrës i është drejtuar KV-së pranë Prefektit të Qarkut Durrës për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

10. Me shkresën e datës 13.07.2010, KV-ja pranë Prefektit të Qarkut Durrës i është përgjigjur Zyrës Përbarimore Durrës se, bazuar në ligjin nr.9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", dhe VKM nr.224, datë 19.02.2009 "Për procedurat e krijimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, si pasojë e korrigjimeve, të kryera nga komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë", autorizimi për lëshimin e aktit të marrjes së tokës në pronësi jepet pasi është krijuar dokumentacioni i ri, ku parashikohet edhe dokumentacioni që duhet të paraqesin qytetarët dhe informacioni që merr KV-ja nga institucionet përkatëse. Në këto kushte, sipas subjektit të interesuar, ekzekutimi nuk mund të bëhet brenda afatit 10 ditor të caktuar nga Zyra Përbarimore, pasi vendimi merret vetëm pasi të përfundojë procedura e administrimit të dokumentacionit të ri.

11. Me shkresën e datës 30.12.2010, nga ZVRPP-ja Krujë i është dërguar KV-së pranë Prefektit të Qarkut Durrës informacioni lidhur me pasuritë e shtetasve Refat Dervina dhe Ibrahim Dervina, që i referohen pasurive të marra në pronësi nga kërkuarit me formularin nr.6.

12. Me shkresën e datës 07.10.2011, Zyra Përbarimore Durrës i është drejtuar përsëri KV-së pranë Prefektit të Qarkut Durrës, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe pajisjen e kërkuarve me aktin e marrjes së tokës në pronësi sipas formularit nr.6, duke e informuar subjektin, gjithashtu, se kanë kaluar afatet ligjore dhe se në rast të mosekzekutimit do të aplikohen sanksione me gjobë, si dhe kallëzim për ndjekje penale ndaj personave përgjegjës.

13. Me shkresën e datës 11.10.2011, Prefekti i Qarkut Durrës i përgjigjet Zyrës Përbarimore, se KV-ja pranë Prefektit të Qarkut Durrës momentalisht nuk mund të kryejë veprime e të marrë vendime për shkak të pezullimit të funksionimit, bazuar në ligjin nr.9948, datë 07.07.2008.

14. Me dy kërkesa të veçanta të datës 21.11.2011, kërkesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Në mënyrë të përmbledhur, ata parashtrorjnë se:

14.1 Organet administrative, edhe pse kanë detyrimin kushtetues për të vepruar në përputhje me parimin e ligjshmërisë, të barazisë dhe të proporcionalitetit, dhe çka është më e rëndësishme t'i binden kontrollit të ushtruar nga organet gjyqësore, përsëri nuk kanë lëshuar aktet e urdhëruara nga gjykata.

14.2 Administrata publike nuk është një debitor i zakonshëm, i cili duhet patjetër të presë daljen e urdhrin të ekzekutimit për të përmbushur detyrimet e saj kushtetuese.

14.3 Në rastin konkret, jemi para detyrimit të një organi administrativ për të lëshuar një vërtetim dhe, në këto kushte, ky proces nuk mund të konsiderohet as kompleks dhe as i jashtëzakonshëm. Nuk ka asnjë shkak të arsyeshëm që të justifikojë një pritje prej 10 vjetësh, ndërkohë që procesi duhej të ishte mbyllur brenda 3 muajve.

14.4 Pas një vendimi gjyqësor, i cili detyron organin administrativ të lëshojë një akt administrativ me parametra të caktuar, organi zhvishet nga çdo lloj pushteti diskrecional dhe është i detyruar të zbatojë në mënyrë të përpiktë vendimin gjyqësor. Edhe pse ka kaluar më shumë se një vit nga nxjerrja e urdhrin të ekzekutimit, përsëri organi administrativ nuk ka përmbushur detyrat e veta ligjore dhe kushtetuese.

15. Gjykata, në mbështetje të nenit 1, pika 2 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", në lidhje me nenin 57 të Kodit të Procedurës Civile, meqenëse kërkesat kanë lidhje dhe objekti është i njëjtë, vendosi bashkimin dhe shqyrtimin e tyre në një çështje të vetme.

16. **Subjekti i interesuar, KV-ja pranë Prefektit të Qarkut Durrës**, me shkresën nr.prot 9/1, datë 25.01.2012, parashtron para Gjykatës se:

16.1 Në bazë të ligjit nr.9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", ky subjekt nuk ka kompetencë të pajisë me titull pronësie asnjë shtetas, por vetëm të verifikojë ligjshmërinë e titujve të pronësisë të dhënë nga ish-komisionet e ndarjes së tokës.

16.2 KV-ja pranë Prefektit të Qarkut Durrës filloi procesin e verifikimit të titujve të pronësisë, për parcelat objekt konflikti, menjëherë pasi kërkesit aplikuan pranë kësaj zyre me kërkesat nr.298 dhe nr.299, të datës 18.12.2008. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se parcela nr.88/2 është një nga parcelat përbërëse të aktit të marrjes së tokës në pronësi në emër të kërkesit Petrit Ziri, pra ky shtetas e ka titullin e pronësisë për këtë parcelë, por ZVRPP-ja Krujë e ka regjistruar atë në emër të shtetasit Ibrahim Dervina. Në lidhje me parcelën nr.88/1, që pretendohet nga kërkesi Besim Ziri, ajo rezulton e regjistruar në emër të shtetasit Refat Dervina.

16.3 KV-ja pranë Prefektit të Qarkut Durrës ka kërkuar nga ZVVRP-ja Krujë informacion në lidhje me dokumentacionin e paraqitur për regjistrimin e këtyre pasurive nga shtetasit Dervina. Pasi të ketë të gjithë informacionin e nevojshëm, në bazë të ligjit nr.9948, datë 07.07.2008, ky komision merr vendimin përkatës për ligjshmërinë e këtyre titujve të pronësisë dhe vendimin për paligjshmërinë e titullit të pronësisë e dërgon në gjykatë, për anulimin e tij. Pavarësisht sa më sipër, komisionet vendore nuk mund të marrin vendime në këtë periudhë, pasi ligji nr.9948, datë 07.07.2008, ka pushuar së vepruari që nga muaji gusht 2011, dhe janë në pritje të shtyrjes së këtij afati.

II

A. Lidhur me pretendimin për mosekzekutimin, brenda një afati të arsyeshëm, të vendimeve gjyqësore të formës së prerë

17. Gjykata ka interpretuar në jurisprudencën e saj parimin e shtetit të së drejtës i cili, si një



nga parimet themelore të një shoqërie demokratike, përmban në vetvete edhe detyrimin e autoriteteve publike për të vënë në ekzekutim vendimet gjyqësore të formës së prerë. Zbatimi i plotë dhe efektiv i vendimeve gjyqësore është me rëndësi thelbësore për shtetin, me qëllim që të krijojë, forcojë dhe zhvillojë një sistem gjyqësor të respektueshëm nga të gjithë (*shih vendimet nr.8, datë 23.03.2010; nr.13, datë 22.04.2011; nr.13, datë 21.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë përbën një element të rëndësishëm të së drejtës për proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Në opinionin e Gjykatës, gjykimi nuk duhet konceptuar ngushtë, vetëm me sigurimin e një vendimi gjyqësor, por me përfundimin e gjithë këtij procesi, sepse një e drejtë e fituar mbetet pa asnjë vlerë nëse nuk realizohet nëpërmjet ekzekutimit të vendimit (*shih vendimin nr.6, datë 31.03.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individ i ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Në këtë fazë duhet të marrin pjesë aktivisht jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar, kur debitori refuzon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij karshi kreditorit. Në raste të tilla mund të thuhet se procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave për rastin konkret, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimin nr.49, datë 21.11.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Parimet lidhur me procesin e rregullt ligjor dhe detyrimin për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, janë të një rëndësie akoma më të madhe në kontekstin e procedurave administrative që kanë të bëjnë me një mosmarrëveshje, rezultati i të cilës është vendimtar për të drejtat civile të kërkuarit. Mbrojtja efektive e një pale në procedura të tilla dhe rikthimi i ligjshmërisë nënkupton një detyrim për autoritetet administrative të zbatojnë vendimet e gjykatës. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se autoritetet administrative përbëjnë një element të shtetit të së drejtës dhe, si pasojë, interesat e tyre përputhen me nevojat për administrimin e mirë të drejtësisë (*shih vendimin nr.6, datë 07.03.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata ka theksuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e saj, sjelljen e kërkuarit dhe sjelljen e autoriteteve publike.

i) *Lidhur me kompleksitetin e çështjes.*

21. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, volumin e provave shkresore. Gjykata vëren se çështja objekt gjykimi nuk paraqet kompleksitet nga pikëpamja faktike. Për sa i përket ligjit të zbatueshëm, rezulton se në vitin 2008 ka hyrë në fuqi ligji nr.9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i cili në nenin 17, pika 2, parashikon, mes të tjerash, se në datën e hyrjes në fuqi të tij, komisionet e tokës, të krijuara në bazë të nenit 7 të ligjit nr.7501 “Për tokën”, mbarojnë funksionimin dhe veprimtarinë e tyre për ndarjen e tokës dhe ato e dorëzojnë të gjithë dokumentacionin ekzistues të ndarjes së tokës në seksionin e administrimit dhe mbrojtjes së tokës (SAMT) në qark. Në pikën 3 të këtij neni parashikohet, gjithashtu, se : “*Të gjitha ankesat dhe kërkesat me shkrim të personave fizikë dhe juridikë, që janë bërë dhe regjistruar pranë komisioneve të tokës së komunave dhe/ose bashkive dhe komisioneve të tokës së këshillave të qarqeve, për të cilat nuk janë përfunduar procedurat e shqyrtimit dhe të marrjes së vendimeve përkatëse, i kalojnë KV-së me procesverbal brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.*” Në bazë të nenit 8 të këtij ligji, KV-ja ka detyrë dhe përgjegjësi, mes të tjerash, edhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të evidentuara ndërmjet individëve

dhe ish-komisioneve të tokës së fshatit. Në bazë të këtij ligji, kompetencat e KNT-së pranë bashkisë Krujë i kanë kaluar KV-së pranë bashkisë Durrës dhe në kushtet kur është parashikuar edhe organi i ngarkuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të pazgjidhura mes individëve dhe ish-komisioneve të tokës, Gjykata vlerëson se kjo çështje nuk paraqet kompleksitet as nga pikëpamja e ligjit të zbatueshëm.

ii) *Lidhur me sjelljen e kërkuësve*

22. Bazuar në nenin 511 të KPC-së, titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim me kërkesë të kreditorit. Për këtë qëllim lëshohet urdhri i ekzekutimit, brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së kreditorit. Neni 515 i KPC-së parashikon se urdhri i ekzekutimit vihet në ekzekutim nga shërbimi përmbartimor gjyqësor, shtetëror ose privat, me anë të përmbartuesit gjyqësor, në bazë të kërkesës së kreditorit. Në lidhje me sjelljen (veprimet) e kërkuësve, rezulton se ata kanë vepruar në përputhje me të drejtat e tyre procedurale. Fillimisht ata i janë drejtuar KNT-së Krujë për pajisjen me aktin e marrjes së tokës në pronësi. Duke qenë se kanë hasur në refuzimin e kësaj të fundit, ata i janë drejtuar gjykatës dhe pasi janë pajisur me vendimet gjyqësore të formës së prerë, të ekzekutueshëm, në favor të tyre, i janë drejtuar organit të ngarkuar nga ligji për këtë qëllim, për ekzekutimin e këtyre vendimeve.

iii) *Lidhur me sjelljen e autoriteteve publike*

23. Gjykata ka theksuar se shteti duhet të marrë përsipër, vazhdimisht, detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion nëse sistemi ligjor ose zbatimi i tij në praktikë do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetej inefektiv dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë (*shih vendimin nr.43, datë më 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Nëse duhet të mbrohen efektivisht të drejtat dhe të respektohet shteti i së drejtës, autoritetet administrative janë të detyruara, rrjedhimisht, të ekzekutojnë vendimet gjyqësore të formës së prerë. Kur autoritetet administrative refuzojnë, neglizhojnë ose vonojnë t'i ekzekutojnë këto vendime, garancitë, që gëzon një palë e përfshirë në një proces gjyqësor, e humbasin qëllimin e tyre (*shih vendimin nr.8, datë 23.03.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar gjithashtu se një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimet nr.6, datë 06.03.2009; nr.43, datë 19.12.2007; nr.8, datë 23.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në lidhje me sjelljen e autoriteteve publike të përfshira në këtë proces duhet të shqyrtohet sjellja e secilit prej tyre. Për sa i përket veprimeve të Zyrës Përmbartimore, Gjykata vlerëson se ato kanë qenë formale. Edhe pse ajo i ka dërguar disa shkresa debitorit për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, nuk rezulton që të ketë marrë ndonjë masë tjetër ligjore, siç është vendosja e sanksioneve apo dhe kallëzimi penal për pengim të ekzekutimit.

25. Në lidhje me sjelljen e debitorit, rezulton se KV-ja pranë Prefektit të Qarkut Durrës pretendon se autorizimi për lëshimin e aktit të marrjes së tokës në pronësi jepet pasi është krijuar dokumentacioni i ri për titullin e pronësisë dhe se vendimi merret vetëm pasi të përfundojë procedura e administrimit të dokumentacionit të ri. Madje debitori justifikohet edhe me faktin se bazuar në ligjin nr.9948, datë 07.07.2008, këto komisione kanë pushuar së vepruari që nga muaji gusht 2011 dhe ato janë në pritje të shtyrjes së këtij afati.

26. Gjykata vëren se, bazuar në nenin 18 të ligjit nr.9948, datë 07.07.2008, verifikimi i titujve të pronësisë, sipas dispozitave të këtij ligji, duhej të përfundonte brenda 3 vjetëve nga data e hyrjes së tij në fuqi, pra deri në gusht 2011. Nga korrespondenca, bashkëlidhur kërkesës, midis debitorit dhe Zyrës Përmbartimore Durrës apo dhe institucioneve të tjera, si Ministria e Drejtësisë, rezulton se debitori ka kërkuar informacion nga ZVRPP-ja Krujë lidhur me dokumentacionin e regjistrimit të këtyre pasurive në pronësi të shtetasve Dervina, me qëllim të verifikimit të titujve të pronësisë të këtyre të fundit. Ndërkohë që, referuar vendimeve gjyqësore të formës së prerë, kërkimet e kërkuësve dhe disponimet e gjykatës lidhen me pajisjen e tyre me aktin e marrjes së tokës



në pronësi, sipas formularit nr.6, një dokument ekzistues i lëshuar që në vitin 1991 nga KNT-ja pranë bashkisë Krujë dhe që, me hyrjen në fuqi të ligjit nr.9948, datë 07.07.2008, së bashku me të gjithë dokumentacionin ekzistues të ndarjes së tokës, i është dorëzuar SAMT-së në qark. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se verifikimi i titujve të pronësisë, bazuar në ligjin nr.9948, datë 07.07.2008, është një procedurë e ndryshme nga konflikti në fjalë dhe, si e tillë, nuk e pengonte debitorin të ekzekutonte vendimet gjyqësore të formës së prerë. Për më tepër Gjykata vëren se debitori, në parashtrimet me shkrim drejtuar kësaj Gjykate ka pretenduar se ai nuk ka kompetencë të pajisë individët me tituj pronësie, por vetëm të verifikojë ligjshmërinë e titujve të pronësisë, por nuk rezulton që ai ta ketë ngritur më parë këtë pretendim apo dhe të ketë shfrytëzuar ndonjë nga mjetet ligjore në fuqi për kundërshtimin në rrugë gjyqësore të procedurave të vëna në lëvizje nga përmbaruesi gjyqësor.

Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se organet shtetërore, nëpërmjet sjelljes së tyre, kanë cenuar të drejtën e kërkuarit për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe vijues të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës, duke konstatuar cenimin e të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e moszbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Petrit Ploçi, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza, Fatmir Hoxha

Anëtarë kundër: Xhezair Zaganjori, Vitore Tusha

VENDIM

Nr.31, datë 17.5.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i	Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar	i	“ “
Petrit Ploçi	Anëtar	i	“ “
Vitore Tusha	Anëtare	e	“ “
Sokol Berberi	Anëtar	i	“ “
Fatmir Hoxha	Anëtar	i	“ “
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e	“ “
Admir Thanza	Anëtar	i	“ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“ “

me sekretare Edmira Babaj, në datë 19.1.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh çështjen nr. 42/18 Akti që i përket:

KËRKUES: Gjykata e Lartë
SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Shqipërisë, Këshilli i Ministrave
OBJEKTI: Vlerësimi i pajtueshmërisë së nenit 147, pika 4 dhe 6 të Kodit të Procedurës Penale me nenet 3, 4, 42/2 dhe 135 të Kushtetutës.
BAZA LIGJORE: Neni 145, paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Xhezair Zaganjori dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.111, datë 13.3.2007 ka vendosur: “Deklarimin fajtor të të pandehurit S.F.V, për kryerjen e veprës penale të dezertimit parashikuar nga neni 33/1 i Kodit Penal Ushtarak dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim”. I pandehuri është gjykuar në mungesë dhe dënimi është vënë në ekzekutim me datë 11.5.2007 nga policia gjyqësore e Komisarariatit të Policisë nr.2 Tiranë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.948, datë 24.5.2007 ka vendosur: “Pranimin e pjesëshëm të kërkesës. Rivendosjen në afat të ankimit të kërkesit Stilian Vathi kundër vendimit gjyqësor nr.111, datë 13.3.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.”

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.24, datë 13.9.2007, vendosi: “Lënien në fuqi të vendimit nr.111, datë 13.3.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.1569, datë 9.11.2007 ka vendosur: “Pranimin e kërkesës. Rivendosjen në afat të ankimit për në Gjykatën e Lartë kundër vendimeve gjyqësore nr.111, datë 13.3.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimit nr.24, datë 14.9.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë”.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë ka paraqitur rekurs i gjykuari Stilian Vathi, nëpërmjet avokatit të tij, i cili ka kërkuar prishjen e tij dhe kthimin e çështjes për rigjykim. Mbi rekursin e të gjykuarit në Gjykatën e Lartë, për të cilën i gjykuari ishte rivendosur në afat nëpërmjet vendimit nr.1569, datë 9.11.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Kolegji Penal ka marrë në shqyrtim çështjen dhe ka vendosur ta kalojë atë në Kolegjet e Bashkuara për njësimin e praktikës gjyqësore lidhur me këto çështje:

a) Kundër vendimit të gjykatës që lejon rivendosjen në afat për bërjen e rekursit a mund të bëhet ankim nga palët para shqyrtimit të çështjes së themelit në Gjykatën e Lartë dhe cili konsiderohet vendim përfundimtar, sipas kuptimit të nenit 147/5 të KPP-së?

b) Nëse Gjykata e Lartë, gjatë shqyrtimit të rekursit, konstaton se vendimi i rivendosjes në afat vjen ndesh me ligjin, a ka të drejtë ajo të ndërhyjë në këtë vendim nëse nuk ka rekurs nga palët ndaj vendimit të themelit nisur nga pengesa e ligjit për ankimin ndaj vendimit që lejon rivendosjen në afat?

c) Nëse në gjykimin e çështjes në gjykatën e apelit, njëra nga palët kërkon mospranimin e ankimit me arsyetimin se vendimi që ka pranuar kërkesën për rivendosjen në afat është në kundërshtim me ligjin, a ka të drejtë gjykata e apelit të shqyrtojë këtë kërkesë pa i hyrë shqyrtimit gjyqësor të themelit, nisur nga përmbajtja e nenit 147/5 të KPP-së, sipas të cilit vendimi që lejon rivendosjen në afat mund të ankimohet vetëm me vendimin përfundimtar?

Kërkesi, Kolegjet e Bashkuara, gjatë shqyrtimit të çështjes për unifikimin e praktikës gjyqësore, kanë arritur në përfundime dhe qëndrime të ndryshme lidhur me disa aspekte, të cilat konsistojnë kryesisht në këto linja:

a) Vetëm gjykata e shkallës së parë ka të drejtë të rivendosë të drejtën e ushtrimit të ankimit



si në gjykatën e apelit, ashtu edhe të rekursit në Gjykatën e Lartë. Sipas këtij qëndrimi, si gjykata e apelit ashtu edhe Gjykata e Lartë janë të detyruara t'u binden vlerësimit të provës dhe të zbatimit të ligjit të bërë nga gjykata më e ulët. Njëkohësisht, ato janë të detyruara t'i zgjidhin në themel çështjet, vetëm pas vendimit të dhënë nga gjykata e rrethit.

b) Në rastin kur gjykata e shkallës së parë vendos pranimin e kërkesës për rivendosjen në afat të ankimit në gjykatën e apelit, ky vendim është i paankimueshëm në rrugë të posaçme. Ai duhet të ankimohet bashkë me vendimin përfundimtar. Pra, palët, në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, mund të ngrenë pretendime si lidhur me aspekte të ndryshme të zgjidhjes në themel të çështjes ashtu edhe pretendime që lidhen me kundërligjshmërinë e kërkesës për rivendosjen në afat.

c) Në lidhje me pranimin e kërkesës për rivendosje në afat mungon një shkallë ankimi, e cila natyrisht duhet të ishte gjykata e apelit.

d) Përmbajtja e nenit 147/5 të KPP-së le përshtypjen që Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk mund të shqyrtojë në mënyrë autonome pretendimin se rivendosja në afat nga gjykata e shkallës së parë është në kundërshtim me ligjin. Kolegji Penal duhet ta shqyrtojë çështjen duke iu nënshtruar vendimit të një gjykate më të ulët.

e) Kërkesën për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit duhet ta shqyrtojë ajo gjykatë që do të kishte kompetencën për të shqyrtuar vetë mjetin e ankimit që rivendoset në afat. P.sh nëse kërkohet rivendosja në afat e ankimit në gjykatën e apelit, kërkesën duhet ta shqyrtojë gjykata e apelit.

Kolegjet e Bashkuara janë të mendimit se rregullimet përkatëse të KPP, objekt kërkese, bien ndesh me parimin e dhënies së drejtësisë nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimin e drejtësisë efektive dhe atë të procesit të rregullt ligjor.

Subjekti i interesuar

1. *Kuvendi i Shqipërisë* deklaroi se dispozitat objekt shqyrtimi janë në përputhje me standartet kushtetuese dhe se kërkesa e Kolegjeve të Bashkuara nuk duhet pranuar për këto arsye:

1.1 Interpretimi i Kolegjeve të Bashkuara se neni 147/6 i KPP-së nuk i jep të drejtën asaj për të shqyrtuar kërkesën ose ankimin për rivendosje në afat është i ngushtë dhe i cunguar duke lënë mënjanë parimet e gjykimit në të gjitha shkallët e sistemit gjyqësor.

1.2 Pretendimi i Kolegjeve të Bashkuara se neni 147 i KPP vjen në kundërshtim me të drejtën e ankimit nuk qëndron, pasi personit nuk i është mohuar e drejta e ankimit, përkundrazi, ai e ka ushtruar atë si për rivendosjen në afat edhe për themelin e çështjes.

1.3 Kolegjet e Bashkuara rezultojnë se janë shprehur me një vendim unifikues për njësimin e praktikës dhe në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi dhe sipas tij, Gjykata e Lartë e ka tagrin e plotë për t'u investuar në ekzaminimin dhe kontrollin e respektimit të standarteve kushtetuese dhe procedurale për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit. Nëse do të pranohej një qëndrim i ndryshëm nga ai i shprehur në vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë, atëherë do të shkactohej një inkoherencë në praktikën unifikuese gjyqësore të deritanishme të Gjykatës së Lartë.

Këshilli i Ministrave deklaroi se kërkesa nuk duhet të pranohet, për sa më poshtë:

2.1 Kolegjet e Bashkuara nuk legjitimohen në kërkimet e tyre pasi:

2.1.1 Nuk kanë përcaktuar mjaftueshmërisht objektin e antikushtetutshmërisë. Nuk është fiksuar në terma ligjorë objekti i çështjes dhe as parashtrimi i mjaftueshëm i shkaqeve për të cilat kërkohet shfuqizimi i ligjit.

2.1.2 Nuk ekziston lidhja e drejtpërdrejt e normës së kundërshtuar si antikushtetuese me zgjidhjen e çështjes para Gjykatës së Lartë. Ajo nuk ka arritur ta paraqesë në formën e duhur dhe me argumente të mjaftueshme çështjen kushtetuese para Gjykatës Kushtetuese. Gjykata referuese në fakt ka formuluar një çështje të interpretimit dhe unifikimit të ligjit dhe jo një çështje kushtetutshmërie të mirëfilltë. Gjithashtu, mungesa e lidhjes së normës së zbatueshme dhe çështjes

mungon edhe për shkak se në ankim pretendohet pavlefshmëria absolute për shkak se janë shkelur dispozitat ligjore lidhur me njoftimin e të pandehurit, prandaj rivendosja në afat e së drejtës së ankimit nuk mund të kërkohet për arsye që kanë të bëjnë me mungesën e lindjes së raportit procedural dhe pavlefshmërinë e gjykimit. Ngritja e pavlefshmërisë së njoftimit të vendimit të dhënë në mungesë dhe kërkesa për rivendosje në afat janë të papajtueshme midis tyre, sepse e fundit presupozon pajtueshmërinë me procedurën e aktit, përmbushja e të cilit është e lidhur me kalimin e afatit të mbaruar.

2.1.3 Lidhja e normës me çështjen para gjykatës referuese mungon gjithashtu edhe për faktin se asnjë nga palët nuk ka kundërshtuar rivendosjen në afat të rekursit, prandaj çështja e zbatueshmërisë së pikës 5 ose 6 të nenit 147 të KPP-së nuk mund të ngrihet para Gjykatës Kushtetuese pasi nuk gjen zbatim për Gjykatën e Lartë.

2.1.4 Gjykata referuese nuk ka gjetur ndonjë shkak për mospranimin e rekursit dhe ka vendosur shqyrtimin e çështjes në kolegji. Në këtë mënyrë ajo ka përfunduar fazën e procesit gjyqësor të shqyrtimit paraprak. Kundërshtimi i rivendosjes në afat të ushtrimit të rekursit nuk mund të ngrihet dhe të shqyrtohet gjatë fazës së shqyrtimit të themelit të rekursit për më tepër pa patur një ankim formal mbi të.

2.2 Pretendimi i Kolegjeve të Bashkuara se neni 147 i KPP-së detyron Gjykatën e Lartë t'i bindet detyrimisht vlerësimit dhe zbatimit të ligjit nga gjykata më e ulët është i pabazuar, pasi vendimi i dhënë nga gjykata më e ulët i nënshtrohet kontrollit gjyqësor hierarkik.

2.3 Termi “organi që procedon” duhet të nënkuptojë gjykatën që është caktuar nga sistemi gjyqësor për kryerjen e akteve përkatëse të nevojshme për përfundimin e fazës që gjendet para saj. Kur kërkesa për rivendosje refuzohet në shkallë të parë, ankimi mund të bëhet në apel dhe më pas në Gjykatë të Lartë. Në këtë këndvështrim, instituti i rivendosjes në afat i së drejtës së ankimit ruan autonominë e tij në raport me procesin kryesor por në të njëjtën kohë edhe ankimi ruan autonominë e tij, pasi elementët e pranueshmërisë hetohen në mënyrë të pavarur nga gjykata kompetente për ankimin.

2.4 Nuk qëndron pretendimi se nëpërmjet nenit 147 të KPP-së cenohet neni 135 i Kushtetutës, pra e drejta e gjykatave më të larta për të vlerësuar në mënyrë të pavarur mbi kriteret e pranueshmërisë në lidhje me procedimin e kërkesës ankimore. Gjykatave më të larta u njihet e drejta për t'u shprehur në mënyrë të pavarur në përputhje me ligjin dhe parimet e procedimit penal pa rënë në kundërshtim me hierarkinë funksionale të sistemit të gjykatave në Republikën e Shqipërisë.

II

Për pretendimin mbi legjitimitimin e kërkesit

Gjykata Kushtetuese (Gjykata) çmon të ndalet fillimisht në çështjen e legjitimitimit të Kolegjeve të Bashkuara si gjykatë referuese që ka kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së dispozitave të KPP-së për shkak se ky pretendim është ngritur nga subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave.

Gjykata konsideron se gjykatat e të gjitha shkallëve, në përputhje me nenet 134/1, shkronja d dhe 145/2 të Kushtetutës, mund të ushtrojnë kontrollin e kushtetutshmërisë së normave që çmojnë si antikushtetuese, duke pasur si parakusht që kushtetutshmëria e normës së referuar të ketë lidhje të drejtpërdrejtë me zgjidhjen e çështjes konkrete. Në përputhje me parimin e drejtësisë efektive, gjykata referuese ka për detyrë të shohë në tërësi pozitat procedurale dhe materiale të palëve dhe gjendjen e tyre pas zgjidhjes së çështjes konkrete. Nëse gjykata ka bazë të arsyeshme të vlerësojë se zgjidhja e çështjes nga ana e saj mund të çojë në cenimin e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, atëherë ajo është plotësisht e autorizuar që t'ia referojë çështjen për zgjidhje të problemit të kushtetutshmërisë Gjykatës Kushtetuese (*Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.1/2011*). Neni 145/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i njeh të drejtën gjyqtarëve që, në çdo fazë të



gjykimit, kur çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, të mos i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese.

Në zbatim të dispozitës kushtetuese të përmendur më sipër, ligji nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 68, përcakton disa kushte, të cilat duhet të respektohen nga gjykata për të kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit përpara Gjykatës Kushtetuese. Së pari, gjykata referuese gjatë një procesi gjyqësor duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete (lidhjen e drejtpërdrejtë); së dyti, duhet të parashtrijë arsye serioze për jokushtetutshmërinë e këtij ligji (të një ose të disa dispozitave të ligjit) duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës.

Gjykata është shprehur gjatë jurisprudencës së saj se gjykata referuese duhet të sqarojë me kujdes lidhjen e drejtpërdrejtë midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete. Evidentimi i kësaj lidhjeje është i domosdoshëm në kuptim të nenit 68 të ligjit për Gjykatën Kushtetuese (*Shih vendimet nr.5/2009; nr.2/2010; nr.30/2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Më tej ajo ka theksuar se “... Para marrjes së vendimit të pezullimit gjyqtari apo gjykata duhet të kenë parasysh që gjykimi që ata kanë nisur nuk mund të përfundojë pa i dhënë përgjigje çështjes së antikushtetutshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Pra, gjyqtari duhet të krijojë mendimin se ligji që ai vlerëson si antikushtetues do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes. Në të kundërt, nëse gjyqtari vlerëson se një ligj që sipas tij është antikushtetues nuk do të zbatohet nga ana e tij për zgjidhjen e çështjes, ai duhet të vazhdojë me gjykimin e çështjes. Në mënyrë që të ekzistojë lidhja e drejtpërdrejtë duhet të ketë një raport të domosdoshëm mes vendimit të Gjykatës Kushtetuese (zgjidhjes së çështjes së antikushtetutshmërisë së ligjit nga kjo gjykatë) dhe zgjidhjes së çështjes kryesore nga gjyqtari apo gjykata, subjekt iniciues i gjykimin incidental, në kuptimin, që gjykimi nga gjykata e zakonshme nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese” (*Shih vendimin nr.13/2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

Duke iu referuar çështjes konkrete, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si gjykatë referuese, argumenton se çështja është e lidhur drejtpërdrejt me dispozitat që ajo i kundërshton si antikushtetuese, pasi të gjykuarit i është rivendosur në afat e drejta e ushtrimit të rekursit në Gjykatën e Lartë me anë të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, e cila detyron një gjykatë më të lartë të marrë në shqyrtim ankimin ndaj një vendimi penal të formës së prerë. Sipas saj, çështja e kompetencës lëndore është e lidhur direkt me respektimin e procesit të rregullt ligjor dhe gjykimin e çështjes nga një gjykatë e krijuar me ligj, siç elaborohet edhe nga praktika disavjeçare e Gjykatës Kushtetuese. Në këtë aspekt, Gjykata konstaton se kushti formal për t’iu drejtuar kësaj Gjykate, pra pasja e një lidhje direkte të çështjes me ligjin e zbatueshëm, ekziston. Sa i takon kushtit të dytë, pra pamundësisë së gjykatës referuese për të bërë një interpretim konform Kushtetutës të dispozitave që pretendohen si antikushtetuese, mbetet për t’u vlerësuar nga kjo Gjykatë në themelin e kërkesës.

III

1. Për pretendimin mbi cenimin e parimit të gjykimin nga një gjykatë e caktuar me ligj

Në vendimin e marrë nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë (më poshtë: gjykata referuese) argumentohet se neni 147/4 i KPP bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj, pasi nuk përcakton se cila është gjykata kompetente për të shqyrtuar kërkesën për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit.

Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të gjykimin nga një gjykatë e caktuar me ligj, Gjykata në praktikë të vazhdueshme ka konstatuar se “...çështjen e kompetencës ajo e ka parë të lidhur me standardin kushtetues të gjykatës së krijuar me ligj, element ky i procesit të rregullt ligjor dhe i parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ. Përcaktimi i saktë i kompetencës është detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës, sanksionuar në nenin 4 të

Kushtetutës sipas të cilit, e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. Megjithatë Gjykata thekson, se bazuar në nenin 7 të Kushtetutës që sanksionon jo vetëm ndarjen, por dhe balancimin e pushteteve dhe në aktet normative që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të këtij parimi, pushteteve të tjera u është njohur e drejta/kompetenca për të zgjidhur çështjet ose mosmarrëveshjet që kanë lidhje me funksionet e tyre. Parimi i shtetit të së drejtës kërkon gjithashtu që veprimtaria e organeve të administratës publike të rregullohet jo vetëm me ligj, por edhe që kjo veprimtari, në raport me të drejtat e shtetasve, t'i nënshtrohet kontrollit gjyqësor. Prandaj, sipas nenit 42 të Kushtetutës, individit ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës edhe kur cenimi i të drejtave, i lirive dhe i interesave kushtetues e ligjorë të tij ka ardhur nga akti apo veprimtaria e organeve të administratës publike. (shih vendimin nr.27/2009 të Gjykatës Kushtetuese).

Gjykata vëren se në lexim të parë të dispozitës, duket sikur ligjvënësi nuk e ka përcaktuar gjykatën kompetente për të shqyrtuar kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit. Por duke iu referuar interpretimit gjuhësor në zërthimin e togfjalëshit “gjykata që procedon në kohën e paraqitjes së saj (kupto: kërkesën)”, atëherë kuptohet se ligjvënësi e ka lidhur gjykatën kompetente me llojin e ankimit që bën i gjykuari. Pra, nëse i gjykuari do të ankimojë vendimin e shkallës së parë, atëherë logjikisht dhe duke iu referuar dispozitave procedurale, kompetente për shqyrtimin e ankimit do të jetë gjykata e apelit. Nëse i gjykuari do të ankimojë vendimin e gjykatës së apelit, kompetente do të jetë Gjykata e Lartë.

Gjykata konstaton se këtë situatë të qartë procedurale e ngatërron përmbajtja e pikës 6 të nenit 147 të KPP. Sipas saj, “kundër vendimit që refuzon kërkesën për rivendosje në afat mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit”. Ky formulim mund të çojë në përfundimin se kërkesa për rivendosje në afat duhet të paraqitet në gjykatën e shkallës së parë në të gjitha rastet, pavarësisht se ndaj cilit vendim dëshiron të ankohet i gjykuari. Këtë përfundim ka nxjerrë edhe vetë gjykata referuese, e cila me vendimin unifikues të saj nr.2/2002 ka vendosur se “në kuptim të nenit 147 të KPP-së, kërkesa për rivendosje në afat për të bërë ankim bëhet në gjykatën që ka dhënë vendimin dhe si e tillë duhet kuptuar përgjithësisht gjykata e shkallës së parë (gjykata e rrethit gjyqësor përkatës). Kjo rezulton nga përmbajtja e pikave 5 dhe 6 të nenit 147 të KPP ... pavarësisht nëse çështja është shqyrtuar në themel ose jo edhe nga gjykata e apelit, kompetente për të shqyrtuar kërkesën për rivendosjen e afatit të ankimit është gjykata e shkallës së parë. Gjykata e apelit dhe pas saj Gjykata e Lartë shqyrtojnë vetëm ankimet kundër vendimeve respektive...” Pra, nëpërmjet këtij vendimi unifikues të gjykatës referuese është vendosur se gjykata që duhet të procedojë me shqyrtimin e kërkesës për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit, në çdo rast e rrethanë, është gjykata e shkallës së parë. Vetë gjykata referuese e pranon se interpretimi i bërë prej saj të çon në pranimin e qëndrimit se është gjykata e shkallës së parë që vendos si mbi të drejtën e ushtrimit të ankimit në apel ashtu edhe të drejtën e paraqitjes së rekursit në Gjykatën e Lartë. Sipas këtij interpretimi, gjykata e apelit dhe madje vetë Gjykata e Lartë duhet t'i binden vlerësimit të provës dhe zbatimit të ligjit të bërë nga gjykata më e ulët, gjë e cila bie ndesh me parimin e hierarkisë gjyqësore sanksionuar nga neni 135 i Kushtetutës.

Gjykata vlerëson se paqartësia që pretendohet nga gjykata referuese se shprehja “organi që procedon” nënkupton patjetër gjykatën e shkallës së parë, nuk rrjedh nga pika 4 e nenit 147 por nga kuptimi që i është dhënë kësaj shprehje nga vetë gjykata referuese në vendimin unifikues të saj. Shprehja “organi që procedon” i referohet organit që ka dhënë vendimin, ndaj të cilit kërkon të ankohet i gjykuari. Pra, nëse i gjykuari kërkon të ushtrojë ankim ndaj vendimit të apelit, kërkesën për rivendosje në afat duhet ta shqyrtojë gjykata e apelit dhe jo gjykata e shkallës së parë. Në këtë këndvështrim, Gjykata arrin në përfundimin se organi që merr kërkesën për shqyrtim është organi që procedon në kuptim të nenit 147/4 të KPP-së. Për këtë arsye, Gjykata nuk konstaton antikushtetutshmëri të kësaj pike, por vetëm keqinterpretim të dispozitës nga gjykata referuese.

Gjykata çmon se një rol në keqinterpretimin e shprehjes “organi që procedon” luan edhe pika 6 e nenit 147 të KPP. Sipas pikës 6, “ankimi kundër vendimit të refuzimit të kërkesës mund të



bëhet në gjykatën e apelit”, shprehja “në gjykatën e apelit” të çon në përfundimin se mospranimi është vendosur nga gjykata e shkallës së parë. Si rrjedhim, Gjykata vlerëson se kuptimi/zbatimi jo i drejtë i dispozitës së nenit 147/4 rrjedh pikërisht nga togfjalëshi “në gjykatën e apelit” i parashikuar në nenin 147/6 të KPP. Nëse pjesë e këtij togfjalëshi nuk do të ishte “e apelit”, atëherë ankimi do të bëhej në gjykatën më të lartë respektive ndaj vendimit të dhënë nga një gjykatë më e ulët, kompetenca e së cilës do të përcaktohej sipas rastit. Në këtë mënyrë, do të garantohej edhe parimi i gjykatës së caktuar me ligj, parashikuar nga neni 42/2 i Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata çmon se togfjalëshi “në gjykatën e apelit” bie ndesh me nenin 42/2 dhe 135 të Kushtetutës.

2. Për pretendimin e cenimit të të drejtës së ankimit ndaj vendimit për rivendosjen në afat

Një pretendim tjetër i gjykatës referuese është edhe cenimi i së drejtës së ankimit të të gjykuarit në rastin kur nuk pranohet kërkesa e tij për rivendosje në afat.

E drejta e ankimit e parashikuar nga neni 43 i Kushtetutës duhet kuptuar si një mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar individit të drejtën për t’u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj, sipas kuadrit ligjor në fuqi për këtë qëllim (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.5/2009*). Kushtetuta garanton të drejtën e ankimit duke mbajtur parasysh dhe sigurinë juridike dhe parashikueshmërinë e sistemit juridik. Parimi i shtetit të së drejtës do të konsiderohet i respektuar, nëse individit i sigurohet një mundësi ankimi efektiv. Garancia e mjeteve të ndryshme të ankimit ka për qëllim riparimin e një shkelje ligjore nga një instancë më e lartë. Në të mirë të sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë së sistemit ligjor, gjykatat duhet të kujdesen që të zbatohet siç duhet kuadri ligjor dhe kushtetues.

Duke iu referuar çështjes konkrete Gjykata konstaton se e drejta e ankimit ndaj vendimit të pranimit ose jo të kërkesës për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit është e parashikuar shprehimisht në nenin 147 të KPP-së. Duke analizuar përmbajtjen e nenit 147, rezulton se kemi të bëjmë me dy aspekte të ankimit: a) ankimi ndaj vendimit të pranimit të kërkesës për rivendosje në afat, i cili bëhet bashkë me vendimin përfundimtar; b) ankimi ndaj vendimit të refuzimit të kërkesës për rivendosje në afat, i cili mund të bëhet në gjykatën e apelit. Gjykata referuese, në vendimin e saj, arsyeton se “*ankimi ndaj pranimit të kërkesës që bëhet bashkë me vendimin përfundimtar të themelit pa u ndalur tek ligjshmëria e vendimit të rivendosjes në afat, është antikushtetuese, pasi e detyron Kolegjin Penal të shqyrtojë themelin apriori me një vendim të gjykatës më të ulët*”. Duke qenë se vendim përfundimtar, sipas rregullave procedurale, konsiderohet vendimi i gjykatës së apelit, atëherë me të drejtë gjykata referuese arsyeton se ndaj vendimit për pranimin e kërkesës për rivendosje në afat nuk mund të ushtrohet ankimi vete por vetëm bashkë me ankimin mbi themelin. Në këtë rast, Gjykata çmon se Kolegji Penal në të njëjtën kohë duhet të shqyrtojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e kërkesës për rivendosje në afat si dhe bazueshmërinë e ligjshmërinë e themelit të çështjes, gjë e cila nuk përputhet me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë. Lind pyetja: Nëse Kolegji Penal do ta gjente të pambështetur në ligj pranimin e kërkesës për rivendosje në afat, atëherë ç’do të ndodhë me vendimin e themelit nëse gjykata e rrethit ose apelit e ka ndryshuar atë? Rrjedhimisht edhe ky vendim do të konsiderohej si i pabazuar në ligj. Mirëpo në një rast të tillë, zhvillimi i rigjykimit në themel të çështjes, kur më pas Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë mund ta konsiderojë atë të paligjshëm për shkak se kërkesa mbi bazën e të cilit është rihapur gjykimi ka qenë e pabazuar në ligj, do të ishte e pakuptimtë dhe e padobishme për palët në proces. Gjykata çmon se në këtë rast kemi të bëjmë me një të drejtë ankimi jo efektive në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-së, sepse palët, pas rigjykimit në themel, mund të përballen me një rezultat të ndryshëm pa patur mundësi të ankohen paraprakisht lidhur me bazueshmërinë në ligj dhe prova të kërkesës për rivendosjen ose jo në afat të së drejtës së ankimit. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se pretendimi i gjykatës referuese lidhur me mungesën e mjetit të ankimit ndaj

vendimit të pranimit të kërkesës për rivendosi në afat në mënyrë të veçantë, është i bazuar. I takon ligjvënësit të parashikojë një mjet ankimi efektiv lidhur me këtë fazë për të garantuar efektivisht të drejtën kushtetuese të ankimit të garantuar nga neni 43 i Kushtetutës dhe neni 13 i KEDNJ.

Sa i takon ankimit ndaj vendimit të mospranimit të kërkesës që duhet bërë në gjykatën e apelit, Gjykata çmon se gjen vend arsyetimi i dhënë më sipër se në nenin 147/6 të KPP duhet të parashikohet e drejta e ankimit jo në gjykatën e apelit por në gjykatën më të lartë, sipas rastit, pa qenë nevoja e specifikimit të shkallës konkrete, pasi *“organi që procedon”* në raste të ndryshme mund të jetë i ndryshëm. Gjykata rithekson se sipas formulimit aktual të pikës 6 të nenit 147 të KPP, ku e drejta e ankimit kufizohet tek gjykata e apelit, le të nënkuptohet se kompetencën për të shqyrtuar ankimin e ka vetëm gjykata e rrethit gjyqësor, pavarësisht mjetit të ankimit që ushtron i gjykuari.

Për sa më lart, Gjykata, bazuar në analizën në tërësi të dispozitave kushtetuese relevante, fakteve dhe rrethanave të çështjes, arrin në përfundimin se pika 4 e nenit 147 të KPP duhet të interpretohet në mënyrë të tillë që me termin *“organi që procedon”* të kuptohet organi që shqyrton ankimin e paraqitur nga i gjykuari, sipas rastit. Ndërsa pika 6 e nenit 147 të KPP që parashikon të drejtën e ankimit ndaj vendimit të rivendosi në afat në gjykatën e apelit nuk garanton ushtrimin e të drejtës së ankimit para një gjykate të caktuar me ligj, sipas nenit 42/2 të Kushtetutës si dhe bie ndesh me parimin e hierarkisë gjyqësore parashikuar nga neni 135 i Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/a, 134/2/d dhe 145/2 të Kushtetutës, si dhe të neneve 68, 69 dhe 70 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”*, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës për shfuqizimin e pikës 6 të nenit 147 të KPP, për shprehjen *“në gjykatën e apelit”*.

- Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin e pikës 4 të nenit 147 të KPP.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Xhezair Zaganjori, Admir Thanza.

Anëtarë kundër: Petrit Pllloçi, Sokol Berberi, Altina Xhoxhaj.

MENDIM PAKICE

Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën, për sa i takon pranimit të kërkesës së paraqitur nga Gjykata e Lartë në lidhje me pajtueshmërinë e nenit 147, pika 4 dhe 6 të KPP-së, me nenet 3, 4, 42/2 dhe 135 të Kushtetutës, e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice. Në rastin konkret, Gjykata e Lartë, në cilësinë e gjykatës referuese, i është drejtuar Gjykatës duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së dispozitave procedurale penale përkatëse pasi, sipas saj, këto dispozita bien ndesh me parimet e dhënies së drejtësisë nga një gjykatë e caktuar me ligj, të drejtësisë efektive dhe cenojnë procesin e rregullt ligjor. Shumica, nëpërmjet arsyetimit të saj, pasi ka analizuar dispozitat kushtetuese, faktet dhe rrethanat e çështjes, ka arritur në konkluzionin se pika 6 e nenit 147 të KPP-së cenon nenet 42/2 dhe 135 të Kushtetutës, duke shfuqizuar shprehjen *“në gjykatën e apelit”* që përmban kjo dispozitë.



Nuk pajtohem me qëndrimin e shumicës për sa i përket legjitimitit të Gjykatës së Lartë për t'iu drejtuar Gjykatës në çështjen konkrete, për arsyet që vijojnë.

E drejta për të iniciuar gjykimin incidental iu njihet gjyqtarëve nga neni 145/2 i Kushtetutës, sipas të cilit gjyqtarët, në çdo fazë të gjykimit, kur çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato. Në këto raste ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata, në vazhdimësi, në jurisprudencën e saj, ka vlerësuar se që të legjitimohet për të kërkuar kontrollin incidental të normës ligjore për papajtueshmëri me Kushtetutën, gjykata referuese duhet: (i) të ketë përcaktuar/identifikuar ligjin që do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete; (ii) të parashtojë arsye serioze për jokushtetutshmërinë e këtij ligji, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës; (iii) të ketë krijuar bindjen se gjykimi nga ajo nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese; (iv) të ketë vlerësuar nëse ligji i vetëm të cilit duhet t'i referohet për zgjidhjen e çështjes, **mund të interpretohet në përputhje me Kushtetutën** (shih vendimet nr.30/2010; nr.18/2010; nr.12/2010; nr.2/2010; nr.13/2009; nr.5/2009; nr.14/2008; nr.11/2008; nr.3/2008; nr.21/2007; nr.33/2007; nr.3/2006 të Gjykatës Kushtetuese).

Mbledhja e Gjyqtarëve, në vendimin nr. 142, datë 01.12.2011, ka çmuar se në vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve, gjykata duhet të niset nga prezumimi i pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën dhe për sa i përket zgjidhjeve ligjore të aplikuara, duhet të ketë argumente pse shkelin normat dhe vlerat kushtetuese (shih për më shumë vendimin nr. 16, datë 25.07.2008 të Gjykatës Kushtetuese).

Në vështrim të standardeve të mësipërme, duke iu referuar çështjes konkrete, pakica vlerëson se Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk kanë përcaktuar në mënyrë të qartë pretendimet e tyre në kërkesë. Thjesht dhe vetëm konstatimi se, në lidhje me interpretimin e nenit 147 të KPP-së, ekzistojnë qëndrime dhe përfundime të ndryshme të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për sa i përket disa aspekteve të institutit të rivendosjes në afat të së drejtës së ankimit ndaj një vendimi penal, nuk është i mjaftueshëm. Gjykata ka pretenduar se dispozitat e ligjit bien ndesh me standardet e gjykatës së caktuar me ligj, drejtësisë efektive dhe procesit të rregullt ligjor, por nuk ka dhënë argumente bindëse dhe arsye serioze, në kuptimin kushtetues, për sa i përket cenimit të këtyre standardeve. Në parashtrimet e gjykatës referuese mungojnë shkaqet dhe argumentet të cilat përbëjnë bazën ku mbështeten pretendimet për papajtueshmëri me Kushtetutën. Rrjedhimisht, pretendimet për cenim të parimeve të gjykatës së caktuar me ligj, drejtësisë efektive dhe procesit të rregullt ligjor, nuk janë ngritur në nivel kushtetues. Në rastet kur ekzistojnë interpretime të ndryshme të një dispozite ligjore të caktuar, vetë Gjykata e Lartë mund t'u japë zgjidhje situatave të tilla duke unifikuar praktikën gjyqësore. Nuk i takon Gjykatës të zgjidhë probleme që rrjedhin nga keqinterpretimi i tekstit të dispozitës apo kuptimi i ndryshëm që gjykata referuese i jep asaj, si rezultat i vendimmarrjes për qëllime unifikuese. Gjithashtu, është e domosdoshme që gjykata referuese, përpara se t'i drejtohet Gjykatës për kontrollin incidental të normës, të verifikojë nëse ka dispozita të tjera për të zgjidhur çështjen në gjykim dhe, nëse nuk ka, të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën. Në çështjen konkrete, për më tepër, nuk rezulton që Gjykata e Lartë të ketë hetuar në këtë drejtim, apo të ketë kërkuar mundësi interpretimi në pajtim me Kushtetutën të dispozitës ligjore përkatëse.

Në vijim të arsytimit të mësipërm, pakica vlerëson se, gjykata referuese nuk i plotëson kriteret e domosdoshme për vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese, në këndvështrim të nenit 145/2 të Kushtetutës, ndaj kërkesa e saj nuk duhej pranuar.

Anëtarë: Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi, Petrit Plloçi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 23.5.2012
Doli nga shtypi më 25.5.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 38 lekë